



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 16 PRILL 2015**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 16. APRILA 2015. GODINE**

**PRILL - APRIL
2015**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për ta përmirësuar pajtueshmërinë e rregulloreve tatimore në nivel ndërkombëtar dhe zbatimin e rregulloreve FATCA,
5. Emërimi i anëtarëve të Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë,
7. Zgjedhja e kryesuesit të Komisionit Shqyrtues të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim,
8. Emërimi i shtatë (7) anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë,
9. Propozimi i GP të PDK-së dhe GP të LDK-së për caktimin e deputetit Blerim Shala në delegacionin e Qeverisë së Kosovës për bisedime me Serbinë.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja izvan dnevnog reda,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Usvajanje Zapisnika sa prethodne sednice,
4. Razmatranje Nacrta zakona o ratifikaciji Sporazuma između Vlade Republike Kosova i Vlade Sjedinjenih Američkih Država za poboljšanje usaglašenosti poreskih uredbi na međunarodnom nivou i primeni uredbi FATCA,
5. Imenovanje članova Borda Nezavisne komisije za rudnike i minerale,
6. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona o menadžiranju javnih finansija i odgovornostima,
7. Izbor predsedavajućeg Komisije za razmatranje pri Kancelariji regulatora za vodovod i kanalizaciju,
8. Imenovanje sedam (7) članova Saveta Kosova za kulturno nasleđe,
9. Predlog PG PDK i PG LDK za određivanje poslanika Blerim Shala u delegaciji Vlade Kosova za razgovore sa Srbijom.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar kryeministër,
Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta, diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjatë deri në 5 minuta, ndërsa diskutimi i deputetit deri në 3 minuta. Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, fjalën e ka kërkuar zoti Agim Çeku.

AGIM ÇEKU: I nderuar zoti kryetar,
Kryeministër, zëvendëskryeministra,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Jam sot këtu në cilësinë e kryetarit të Komisionit për Verifikimin e Statusit të Veteranëve dhe flas në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

Vazhdimisht, e sidomos kohëve të fundit, po përballemi me presione të shumta dhe kritika të mëdha ndaj Komisionit qeveritar për Verifikimin dhe Statusin e Veteranëve dhe Qeverisë, në përgjithësi, për ecurinë e procesit të verifikimit, për zvarritjen apo vonesën në publikimin e listave dhe për manipulimin, apo fryrjen e listave.

Unë nuk dola këtu sot në foltore për ta arsyetuar veten, Komisionin apo Qeverinë, e as për ta hedhur fajin diku tjetër, por vetëm t'i jap disa sqarime, apo më mirë të them t'i përsëris edhe një herë disa sqarime që i kam dhënë edhe më herët.

Fillimisht, sa i përket procesit: Po, pajtohem edhe unë, edhe Komisioni, se ky është një proces i vonuar dhe tani kur ka filluar po zvarritet dhe po ecën ngadalë, por, siç thotë populli, “më mirë vonë se asnjëherë”.

Ju rikujtoj se procesi ka filluar si rezultat i vullnetit politik dhe përkushtimit të Qeverisë së mëparshme dhe kryeministrit Thaçi për kategoritë e dala nga lufta.

Qeveria e mëparshme u ka kushtuar kujdes të veçantë vlerave të luftës dhe kategorive të dala nga lufta. Të mos e përsëris, e dimë të gjithë atë çfarë është bërë deri më tash.

Përkushtimi dhe vullneti i palodhshëm vazhdon edhe tani në këtë Qeveri. Ju njoftoj se deri më tani, si kryetar i Komisionit, kam pasur dy takime me kryeministrin Mustafa dhe zëvendëskryeministrin Thaçi bashkërisht me bashkëpunëtorë.

Ish-kryeministri Thaçi sa ka qenë kryeministër disa herë ka marrë pjesë në takimet e Komisionit dhe dua ta cek se asnjëherë në as në këto dy takime nuk kam vërejtur ndonjë fakt që mund të përkojë me ndonjë agjendë politike apo ndikim politik dhe ju siguroj se prej fillimit deri në fund ky proces është krejtësisht i zhveshur nga politika, sa i përket Qeverisë dhe sa i përket Komisionit.

Deri në fillim të këtij procesi kemi pasur evidenca të ndryshme të numrit të veteranëve nga organizatat dhe shoqata të ndryshme. Menjëherë pas lufte, IOM-i i ka regjistruar të gjithë ata që vullnetarisht janë paraqitur në zyrat e tyre si pjesëmarrës, apo veteranë të luftës.

Ju rikujtoj se në atë regjistër janë diku 26 700 veteranë, apo ushtarë të UÇK-së të regjistruar. Mandej e kemi pasur një regjistër në Shtabin e Përgjithshëm të TMK-së dhe ekzistojnë regjistrat e shoqatave të kategorive të dala nga lufta.

Por, këto regjistra asnjëherë nuk kanë qenë zyrtarë. Ka mundur të regjistrohet kush ka dashur dhe shumë prej veteranëve që edhe vetë i njoh nuk e kanë parë të arsyeshme që të regjistrohen na IOM, apo nëpër shoqata, por e kanë vazhduar jetën dhe punën e tyre.

Kështu që deri më tani, çdo veteran, pjesëmarrës i luftës, pjesëtar i UÇK-së, e ka pasur një vërtetim, apo një librezë të shoqatave të dala nga lufta, që, në fund të fundit, janë organizata joqeveritare.

Por, tani veteranët, luftëtarët, pjesëtarët, pjesëmarrësit, invalidët, familjet e dëshmorëve do ta kenë vulën e shtetit dhe kjo është ajo çka është më e rëndësishmja.

Normalisht, ashtu qysh e parasheh ligji, të papunët do ta marrin një lloj pensioni, por të gjithë ata që janë në lista do ta marrin certifikatën nga shteti, ndonjë medalje përkatëse, përkujtime për luftën çlirimtare dhe shumë benificione tjera që janë parapara me ligj.

Pritet dhe apeloj te Qeveria që sa më shpejt ta aprovoj udhëzimin administrativ në të cilin do ta përcaktojë lartësinë e pensionit, do t'i përcaktojë kushtet, dokumentet e nevojshme dhe fillimin e realizimit të kësaj të drejte dhe që veteranët ta kenë të qartë se si dhe kur do të fillojë realizimi i drejtave të tyre të parapara me ligj.

Së dyti, sa u përket vonesave në publikimin e listave dhe përfundimit të procesit, siç e dini, procesi ishte dhe është shumë i ndjeshëm dhe shumë voluminoz. Me të marrë detyrën e kryetarit e kam aktivizuar Komisionin, i cili ka qenë i formuar shumë muaj më parë, dhe as që e pati filluar punën dhe kemi filluar të punojmë pa ndërprerë me një dinamikë shumë të madhe. E kemi formuar sekretarinë, kemi përcaktuar procedurat, modalitetet, formën e aplikimit dhe verifikimit.

Dhe, pas një pune të mundimshme dhe shqyrtimit e klasifikimit, sistemimit nëpër njësitë e çdo aplikacioni, ju kujtohet se kanë qenë shumë, afro 67 mijë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Vazhdoja fjalën, të lutem!

AGIM ÇEKU: Kemi qenë të gatshëm dhe ka fillua verifikimi. Verifikimi ka filluar më 10 shkurt 2014, me Zonën Operative të shalës dhe Brigadën 138.

Nga atëherë janë mbajtur mbi 350 takime të ndryshme, në të cilat kanë marrë pjesë rreth 3 000 komandantë të niveleve të ndryshme në verifikim.

Verifikimi është bërë veç e veç, brigadë për brigadë nga zonat e tyre dhe është bërë nga vetë komandantët e brigadave. Domethënë, statusi i aplikuesve është përcaktuar drejtpërdrejt nga komandantët e tyre. Komisioni dhe sekretaria e Komisionit vetëm e kanë menaxhuar, e kanë administruar dhe e kanë përkrahur këtë proces, duke u afuar hapësirë për punë, aplikacione të sistemuara, logjistikën e nevojshme, të gjitha punët administrative, mëditje për të gjithë pjesëmarrësit në këto takime.

Të gjitha njësitë janë shqyrtuar apo vonesat kanë ndodhur shpeshherë për pak, për një numër shumë të vogël të aplikuesve, kur ka pasur paqartësi, apo ndoshta edhe papajtueshmëri ndërmjet komandantëve të tyre.

Tani jemi në përfundim e sipër, deri në fund të kësaj jave, ashtu siç e do rendi, të publikohen edhe listat e Shtabit të Përgjithshëm, të njërive që kanë qenë drejtpërdrejt të lidhura me Shtabin e Përgjithshëm, logjistikës që ka vepruar përgjatë kufirit Kosovë-Shqipëri në atë kohë dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kosovës në ekzil, që pritet të publikohen sot, nesër, apo deri në fund të kësaj jave.

Sa u përket manipulimeve dhe fryrjeve të listave, edhe për këtë fajësohet Komisioni qeveritar. Po e përsëris - statusin e çdo aplikuesi e kanë përcaktuar komandantët e tyre, e jo Komisioni. Nuk ka aplikacion, apo nuk ka veteran që unë, si kryetar i Komisionit, vendos për statusin e tij, apo nënshkruaj për statusin e tij.

Po e shohim se pas publikimit ka reagime të shumta. Po e cek se këto janë listat fillestare, ashtu siç e parasheh ligji. Është faza e parë dhe tani çdo aplikues që është i pakënaqur me statusin e vet ka të drejtë ankese. Deri më tash i kemi marrë diku 7 800 ankesa, që do të thotë diku 15% të aplikuesve janë të pakënaqur me statusin e tyre. Por, ka edhe shumë ankesa, meqë veteranët tjerë ankohen për veteranë që janë në listë e nuk duhet të jenë. Domethënë me këtë nuk janë ankuar veteranët vetëm për veti por është ankua edhe për individ të ndryshëm që mendojnë që ju caktua një status që se meriton.

Tani, ne e kemi formuar Komisionin për shqyrtimin e ankesave, e kemi aprovuar rregulloren e punës dhe menjëherë që nga java e ardhshme do të fillojmë shqyrtimin e këtyre ankesave.

Pas shqyrtimit të ankesave del lista përfundimtare, por këtu do ta cek se ky nuk është fundi i procesit. Pas daljes së listës përfundimtare, prapë vazhdon - çdo aplikues i pakënaqur ka të drejtë të ankohet, por i ankohet Gjykatës Themelore. Çështja mund të vazhdojë me vite të tëra. Pas

listave përfundimtare, veterani i cekur fillon t'i gëzojë benificionet, por gjykata do t'i shqyrtojë ankesat, dhe çdo deklaram i rremë, qoftë nga veterani, çdo nënshkrim i pasaktë nga komandantët, i nënshtrohet procedurës ligjore sipas Kodit Penal dhe konsiderohet si vepër penale.

Pra, u mundova që të sqaroj dhe në fund dua të theksoj se unë, si kryetar i Komisionit, asnjëherë nuk kam pritur mirënjohje për këtë punë dhe për këtë proces, sepse e kam ndier dhe e ndiej si obligim ndaj bashkëluftëtarëve dhe detyrë të ngarkuar nga kryeministri.

Por, gjithashtu, pres një qëndrim korrekt nga të gjithë aktorët e përfshirë në këtë proces, nga veteranët, nga aplikuesit pres mirëkuptim, durim dhe besim. Këto janë listat përfundimtare.

I ftoj veteranët që t'i shfrytëzojnë mekanizmat e përcaktuar me ligj, mekanizmin e ankesës, e jo mediat. Ne si komision nuk mund të reagojmë në bazë të deklarimeve për media. Të ulen të shkruajnë e të afrojnë fakte.

Edhe një sqarim: ne si Komision askujt nuk ia përcaktojmë statusin e invalidit. Ne si Komision, apo komandantët që e kanë bërë verifikimin vetëm konstatojnë që aplikuesi ka qenë i plagosur, apo i lënduar. Në takim me kryeministrin dhe me zëvendëskryeministrin jemi dakorduar që Qeveria do ta emërojë një komision profesional mjekësor, por edhe nga zyra e veteranëve që t'i shqyrtojë këta që prezantojnë që janë invalidë, t'ua përcaktojë shkallën e invaliditetit, apo edhe t'i refuzojë si invalidë.

Prapë po e cek, në qoftë se dikujt i refuzohet statusi i invalidit, edhe sot e gëzon atë status, dhe Komisioni është i ri vlerëson se nuk ka pasur të drejtë ta shfrytëzojë një rast të tillë, Qeveria me një udhëzim administrativ do ta përcaktojë që ato mjete duhet të kthehen me një akt ligjor.

Dhe, në fund dëshiroj, pasi e zgjata pak, por e shoh të arsyeshme, që në emrin tim personal, pasi është edhe kryeministri këtu, e kam një kërkesë ndaj kryeministrit të Qeverisë aktuale që Qeveria duhet të mendojë seriozisht ta themelojë një ministri të re - Ministrinë e Veteranëve, apo mund të quhet edhe ndryshe - Ministria për Ruajtjen dhe Promovimin e Vlerave të Luftës. Jo pse e kanë edhe vendet tjera, por sepse është domosdoshmëri. Sot, kategoritë e dala nga lufta dhe vlerat e luftës trajtohen nga disa ministri, nga disa zyra apo nga disa agjenci.

Synimi i Qeverisë dhe pritja e qytetarëve është që rritja e efikasitetit të Qeverisë, Ministria nuk kërkon rritje të punëtorëve të punëtorëve e shërbyesve civilë dhe nuk do të thotë që duhet të rritet numri i ministrive, por të bëhen bashkë në një ministri të vetme - Departamenti i Veteranëve, që sot është në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Zyra për çështje të kategorive të dala nga lufta që është në Zyrën e Kryeministrit, Zyra për të Pagjeturit, pse jo edhe Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë, për të cilën diskutuam në seancën e kaluar, Zyra e Trashëgimisë së TMK-së që është prapë në Ministrinë e Punës e Mirëqenies Sociale, Zyra për të ish-burgosurit politikë, e shumë, e shumë...

Pra, sot me këto çështje merren disa institucione, dhe askush nuk merret seriozisht dhe të gjithë kanë vërejtje. Qeveria ndan shpesh mjete 'ad hoc' për shoqata të ndryshme, Qeveria formon komisione si ky të cilin e drejtoj unë, këshilla organizativë, për këtë manifestim, për atë

manifestim, e tjerë, e tjerë, kështu që, me një ministri të veçantë do ta kishim një buxhet, një adresë, një përgjegjësi dhe, jo që këto përgjegjësi të shpërndahen dhe të caktohen.

Gjithashtu, propozoj që në Kuvendin e Kosovës të formohet edhe një Komision shtesë, apo ndonjërit prej komisioneve ekzistuese t'i ngarkohet edhe mbikëqyrja e legjislacionit, që merret me veteranë dhe të quhet Komisioni për këtë, këtë dhe veteranët e luftës. Për të mos u rritur numri i ministrive, mund të bashkohen disa ministri, kjo nuk është çështje imja, por vetëm po them që disa ministri, për shembull, Ministria e Administratës Publike, mund të bëhet bashkë me Ministrinë e Administratës së Pushtetit Lokal dhe të quhet Ministria e Administratës, Ministria e Kthimit e Komuniteteve, mund të bëhet bashkë me të Diasporës dhe të quhet Ministria e Diasporës, Komuniteteve dhe Kthimit, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Integritimit Evropian, e tjerë, e tjerë, ka forma të ndryshme. Mendoj se momenti kyç për formimin e kësaj Ministrie, duhet të jetë momenti kur të formohet Ministria e Mbrojtjes e që pres që të formohet shumë shpejt dhe vonesat për këtë çështje janë të pajustificueshme.

E di, por po e përmbyll se edhe shumë deputetë, kolegë, bashkëluftëtarë, do ta ngrenë këtë çështje dhe, në fund, dua të propozoj, pse jo, pse të mos e organizojmë edhe një debat parlamentar për çështjen e verifikimit të veteranëve, të bisedojmë e të shqyrtojmë më gjatë se sa pesë apo gjashtë minuta. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Çeku! Tridhjetetë minuta vazhdon kjo pikë e rendit të ditës, për shkak se e kemi tejkaluar, por mirë është të kërkohet debat, për të mos e tejkaluar kaq gjatë.

Tani e kanë radhën të paraqiturit nga Lidhja Demokratike e Kosovës, pasi nuk ka të paraqitur në emër të grupit parlamentar, është zoti Murat Hoxha, me nëntë dhe me numër njëmbëdhjetë, Melihate Tërmkolli. Kush e merr fjalën? Melihate Tërmkolli e ka fjalën.

MELIHATE TËRMKOLLI: Unë nuk di qysh shkruan atje, e di kryetari, por, pasi më thirri, po dal.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar pjesëmarrës,

Unë, në vazhden e asaj që e tha kryetari i komisionit, do t'i them veç një dy-tri fjalë, shumë shkurt dhe shpejt.

Në fakt, në krejt këtë proces i cili po zhvillohet rreth kësaj, kush ka qenë pjesëtar e kush jo, i UÇK-së, e tjera, e tjera, kemi një politizim të skajshëm dhe, kjo është katastrofave. Kjo është diçka që nuk lejohet, nuk pranohet dhe, po më pyesin shumë njerëz, të cilët vërtetë kanë qenë të kyçur, kanë marrë pjesë, kanë marrë obligime e detyra edhe në fakt, po mbesin jashtë këtyre listave e po hyjnë njerëz me baza tjera politike, partiake, e tjera e tjera dhe, që absolutisht nuk është e drejtë.

Kanë mbetur grupacione të shumta, të cilat nuk janë pjesë e këtyre zhvillimeve. Ne e dimë shumë mirë, të gjithë ata e dinë, unë besoj kryeministri e di shumë mirë, qysh në vitin '90, '91, ne kemi pasur po ashtu një Ministri të Mbrojtjes, e cila i ka vënë bazat e përpjekjeve për luftë në Kosovë, e cila në njëfarë mënyre është paguar nga Qeveria e atëhershme edhe që kurrkund nuk

janë pjesë e këtyre listave, nuk janë në asnjë listë të angazhimeve të tyre dhe të kontributit që kanë dhënë.

Prej këtyre janë diku mbi 200 vjet burg, nga njerëz të cilët janë burgosur për këtë çështje, për këtë punë dhe si të përndjekur nuk hyjnë as në listat e të përndjekurve, as të burgosurve e as kurrkund.

Nëse duam vërtet ta çmojmë një luftë, atëherë ose duhet ta çmojmë tamam, ose lëni krejt. Problemi është, pastaj shumë njerëz të cilët kanë qenë në FARK po ashtu ka probleme të mëdha, ka probleme serioze, ata kanë qenë njerëz luftëtarë të lirisë. Pse e kanë pasur emrin siç e kanë pasur, është shumë e drejtë, ka qenë institucionale dhe krejt në rregull, kanë mbetur njerëz luftëtarë të lirisë jashtë këtyre listave, kanë mbetur jashtë krejt procesit.

Kanë mbetur jashtë procesit, po ashtu shumë njerëz të cilët kanë dhënë jetën për këtë vend edhe nuk janë kurrkund. Nuk po dua ta ngatërroj këtë me UÇK-në, nuk po dua ta ngatërroj me luftën për liri, me luftën në fakt, të armatosur, por si pjesë e luftës për liri, absolutisht janë pjesë e tyre.

Mos të harrojmë, të gjithë ata njerëz që u vranë në Kosovë, a shkuan ata për pleshta, a u vranë për pleshta, a u vranë për këtë liri të Kosovës? U vranë fëmijë, na u vranë njerëz ushtarë, që u kthyen në arkivole. Ne e dimë shumë mirë, e dimë të gjithë, ose një pjesë e tyre e di, një pjesë nuk e di. Flora Brovina e di shumë mirë, e di që u vra Ylfete Humolli, pesë-gjashtëmbëdhjetë vjeç, e di që u vra Shukrije Obërtinca, pesë-gjashtëmbëdhjetë vjeç, e di që u vra Afrim Prebreza, njëmbëdhjetë vjeç, e di që na erdhën plot ushtarë në arkivole, e tjerë. Ku janë ato familje, janë diku apo nuk janë, a luftuan ata njerëz, a u përpoqën edhe ata njerëz për këtë liri të Kosovës apo çka ndodhi me ta? Pse nuk janë kurrkund? Kush kujdeset për ta?

Edhe në fund, zoti kryetar, mos u vononi një orë, as gjysmë ore, ose fillojeni mbledhjen me kohë, ose autorizojeni dikë. Deputetë, neve na vjen ftesa në orën dhjetë, ne e fillojmë mbledhjen në orën 11:00. Më falni! Faleminderit!

KRYETARI: Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar Lëvizja “Vetëvendosje”.

VISAR YMERI: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Dje, të dy kryeministrat e Kosovës e shfrytëzuan mbledhjen e Qeverisë, për të folur për protestën e 18 prillit dhe për këtë i falënderoj.

Është e rëndësishme që të flitet sa më shumë në publik për protestën, në mënyrë që sa më shumë qytetarë të dëgjojnë për të, ta mësojnë orën e datën dhe të flasin për kërkesat e saj. Pak ç’flas me fjalët e tyre, më shumë e shpërfaqën frikën nga protesta, se sa domosdoshmërinë për të reflektuar për shtetin e kapur, që po kërkon ta çlirojë protesta.

Thaçi foli për pushtetin, do të thoshit si zakonisht, se si këto protesta po motuakan ta marrin pushtetin me dhunë. Prapë do të thoshit, frika e tij e zakonshme, por ka diçka më të pazakontë në këtë shpërthim të tijin, shpërfaqja e realitetit, realitet, të cilin tashmë e kanë të qartë të gjithë, realitetin e shtetit të kapur nga pushteti.

Natyrisht se Thaçi reagon kështu dhe pikërisht me këto fjalë. Çfarëdo kërkesë për ta çliruar shtetin e zaptuar, atij i tingëllon sikur synim për t'ia marrë pushtetin, pushtetin që ushtrohet përmes zaptimit e ku ky është zaptuesi. Koka pa mendje e zaptimit, bashkë me Veselin dhe SHIK-un, ose nëse doni, në bashkëpunim me të.

Kjo kapje, që këta e quajnë pushtet apo e drejtë politike, siç e tha Thaçi dje, që qytetarëve u faturohet si çmime super të shtrenjta të energjisë elektrike, si zyrë e Rregullatorit tërësisht në funksion të KEDS-it, si Gjykatë Kushtetuese e kryetar të saj, që falsifikon vendime, si sistem drejtësie që mbron krimin, si politikë haraçi, që përgjak afaristët nga deputetët e zaptuesve, Lata dhe Remi, si ministër Drejtësie, që ia ka nën vendosur gjyqësorin tërësisht nevojave të klanit “Pronto” dhe bandave të Këshillit Prokurorial, si menaxhment i RTK-së, që e shndërron atë në zëdhënës të pushtetit dhe si kundërshtpërbliim përvetëson jashtëligjshëm milionë euro të parasë publike. Politikë zaptuesish, kjo që po e ndajnë Kosovën në dysh duke premtuar e punuar për t'i akomoduar kërkesat e Serbisë për kompetenca ekzekutive për “Zajednicën”.

Për çudinë e disave e jo të gjithëve, natyrisht, të njëjtat gjëra i tha edhe Mustafa, ky kryeministri tjetër. Po, ky kur u kap se? Apo më mirë thënë, kur e kapi shtetin? Prejse e mori postin e kryeministrit apo edhe më herët? Para apo pas 70 dosjeve të dërguara në Prokurori, apo gjatë refuzimit të vazhdueshëm të Prokurorisë për t'i hetuar dhe trajtuar ato dosje?

Që prej vitit 2011, në Kuvendin e Republikës së Kosovës kërkohet vazhdimisht nga deputetët, që të hetohet veprimtaria e SHIK-ut. Isa Mustafa asnjëherë nuk i lejoi deputetët e LDK-së, që ta mbështesin këtë iniciativë. Madje, në mbledhje të Grupit Parlamentar, tash pasi që është bërë kryem ministër, raportohet t'i ketë kërcënuar me përjashtim ata që e mbështetën iniciativën, përkundër vullnetit të tij.

Me uljen në karrigen e kryeministrit, të paktën elektorati i LDK-së, kanë pritur që Mustafa ta mbajë qëndrimin e njëjtë për SHIK-un dhe të angazhohet në çlirimin e shtetit nga zaptimi, por, ky u shndërrua në apologjetin kryesor të tyre. Nuk ka mundur asnjëherë Veseli të bëjë më shumë për shpëlarjen e SHIK-ut, se sa që ka bërë dhe po bën Mustafa, prejse është kryeministër i këtij vendi. Faleminderit!

KRYETARI: Pal Lekaj, në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

PAL LEKAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,
I nderuar kryeministër,
Zëvendëskryeministra,
Ministra,
Deputetë,
Qytetarë të Republikës së Kosovës,
Kaluan pesëmbëdhjetë vjet dhe dështuat në adresimin e krimeve të luftës të kryera nga Serbia. Në ditën kur u bë publike, se kemi hequr dorë nga sovraniteti i vendit, duke sjell Gjykatën Speciale, u munduat ta neutralizoni me Rezolutën kundër gjenocidit të Serbisë. Kjo ishte shumë vonë dhe shumë pak, të nderuar deputetë.

Dy ditë më parë, kryetari i Kuvendit, duke shfrytëzuar Televizionin e RTK-së, me shumë pompozitet paralajmëroi se Kosova padit Serbinë dhe Rezoluta do të vijë në Kuvend.

Të nderuar deputetë, i nderuar kryetar, ku është Rezoluta, pse nuk erdhi apo mos zëvendëskryeministri dhe ministri i Jashtëm e ka zëvendësuar me vizitën e tij në Beograd, mos po shkon atje, për të marrë Rezolutë? Deri kur të vazhdoni me këtë?

Të nderuar deputetë, nuk është hajgare, por ju po bëni hajgare dhe mashtrim me qytetarët e Republikës së Kosovës, prandaj çdoherë kur keni diçka që veproni turpshëm, atëherë mundoheni ta neutralizoni me rezoluta të tilla, që asnjëherë nuk janë implementuar. Do t'u vijë turp një ditë për këtë çështje. Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Isa Mustafa e ka fjalën.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet Qeveritar,

Meqenëse pat apostrofime të veçanta lidhur me seancën e djeshme të Qeverisë dhe lidhur me deklaratat tona, unë vetëm dëshiroj edhe njëherë t'i përforcoj deklaratat, të cilat unë i kam dhënë dhe në Qeveri lidhur me nevojën që problemet me të cilat ne ballafaqohemi në Kosovë, duhet t'i zgjidhim në institucione të Republikës së Kosovës. Pra, ne po bëjmë përpjekje, që ato probleme t'i zgjidhim përmes realizimit të programit qeverisës, përmes mobilizimit dhe natyrisht, se kemi nevojë që të kemi përkrahjen dhe angazhimin e të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Por, natyrisht se ne e dimë se kush sa ka punuar dhe kush sa punon dhe unë e kam të qartë dhe kam thënë publikisht, se jo shtatëdhjetë dosje, po shtatëqind dosje do t'i mbledhë kryetari i Prishtinës, t'i çojë në Prokurori dhe, unë jam koshient për përgjegjësinë time dhe për punën time që kam bërë në Komunën e Prishtinës.

Kështu që, sa i përket asaj urdhëroni, merrni edhe hamall për t'i bartur dokumentet, sepse ne diku kemi realizuar rreth 110 000 lëndë në vit në komunën e Prishtinës dhe keni mundësi për të çuar lëndë sa doni dhe unë barti përgjegjësinë për çdo punë të cilën unë kam bërë në Prishtinë, por edhe ju duhet ta bartni përgjegjësinë për punën që s'po e bëni atje, sepse ju duhet t'u tregoni qytetarëve që po protestoni, po organizoni protesta për qeverisjen se si po e qeverisni komunën e Prishtinës. Cila është pasqyra e juaj e qeverisjes?

Sa i përket SHIK-ut, është mirë që SHIK-un t'ia bëni një komision edhe SHIK-ut tuaj, SHIK-ut të "Vetëvendosjes", njerëzve që po u vëni kamera dhe mikrofona, sepse në qoftë se nuk keni SHIK, atëherë edhe atë bene, edhe mandej i shtimë në një pako dhe i hetojmë të gjithë shik-at.

KRYETARI: E ka fjalën Zafir Berisha, në emër të Grupit Parlamentar "Nisma".

ZAFIR BERISHA: Kërkoj mirëkuptim prej kolegëve deputetë,

Situata e rëndë, më se tepër e rëndë në Kosovë që ka prodhuar qeverisja e keqe, ka krijuar një klimë të pafavorshme për një jetë normale dhe kjo vjen si rezultati i kapjes së shtetit dhe sot jo

rastësisht e kemi një krizë morale në shoqërinë e Kosovës, e cila vjen si rezultat i disa segmenteve të caktuar, të cilët shtetin e kanë bërë pronë private.

Unë do të filloj me drejtësinë, ku kupola e të keqes së vendit është vetë Gjykata Kushtetuese, e cila është e politizuar skajshmërisht dhe i shërben njësive para politike të partive politike, dhe me vendimet e saj, edhe me veprimet e saj, por edhe me falsifikimin e vendimeve të saj, sipas Avokatit të Popullit.

Prokuroria është bërë një teatër tragjiko-komik dhe të them të drejtën ky organ tepër i rëndësishëm i shtetit ka rënë në atë nivel sa që jo rastësisht ky segment i rëndësishëm duke dështuar me qëllim të iniciuar nga njësiti para politike, kanë sjell për rezultat edhe themelimin e Gjykatës Speciale dhe kjo me gjasë është e koordinuar mirë për të gjykuar luftën e drejtë të UÇK-së.

Kur jemi te drejtësia, natyrisht nuk bën pa i përmendur edhe 31 milionë euro të buxhetit të Kosovës dhe të Bashkësisë Evropiane, në Pallatin e Drejtësisë, një dështim katastrofal për të cilin besoj ju dhe të gjithë qytetarët janë në dijeni dhe kjo tregon se faturat e shpenzimeve edhe të Bashkësisë Evropiane në Kosovë, dikush është duke i keqpërdorur.

Një nga elementet që është presioni i vazhdueshëm mbi qytetarët, që është në kuadër të segmenteve tjera të kapura, të cilët janë duke ndikuar edhe në shpërnguljen masovike të qytetarëve jashtë Kosovës, është energjia.

Me çmime tepër të larta, më të larta në rajon dhe me bllok- tarifa të cilët askush nuk i kupton, të cilët e ngarkojnë edhe biznesin, por edhe familjet kosovare. Njehsorët elektrikë, një nga skandalet për të cilët është folur edhe në seancë dhe që edhe ne deputetët jemi të atakuar nga ata njehsorë elektrikë, që dikush nga zyrtarët dhe ish-zyrtarët thotë se kjo çështje është duke u hetuar nga Prokuroria, por kur kemi parasysh një prokurori të kapur, atëherë dihet se edhe kjo do të dështojë dhe do të vdesin shumë vendime tjera.

ZRRE-ja mendoj se e ka humbur udhën në oborr dhe ajo duhet ta ketë të qartë se është për t'i shërbyer dhe mbrojtur konsumatorët, por jo për ta mbrojtur dhe për t'i shërbyer KEDS-it, një mekanizëm i cili natyrisht është bukur i dyshimtë.

RTK-ja është njëra nga faqet më të këqija që paraqet domethënë realitetin në Kosovë dhe në institucionet e Kosovës dhe ajo që po ndodh në RTK është një pasqyrë negative edhe karshi faktorit ndërkombëtar, sepse ne me sjelljet e menaxhmentit të politizuar dhe të njerëzve të politizuar në RTK, po paraqesim të vërtetën e hidhur që është në shoqërinë tonë.

Politizimi ekstrem, domethënë në këtë televizion, punësimi enorm mbi baza politike, keqpërdorimi i parasë publike, një bord i cili asnjëherë nuk i ka dhënë raport këtij Kuvendi, e deri te pushimet nga puna ose përjashtimet nga puna si në kohën e komunizmit.

Unë mendoj se këto tri elemente dhe shumë çështje tjera preokupuese të shoqërisë duhet të fillojnë të shkapen brenda institucioneve, përndryshe më lejoni të shfrytëzoj momentin që t'i ftoj

qytetarët të shtunën të dalin në protestë dhe duke demonstruar ta shkapim shtetin e okupuar nga bandat parapolitike të partive në pushtet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit ! Unë po e thyej Rregulloren me vetëdije, veç ju kisha lutur në gjuhën parlamentare çka bëni... Urdhëro, Visar Ymeri, kundër-replikë një minutë.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Kryeministri e pranoi në fakt atë që e thashë unë, e konfirmoi fjalën time, dhe për këtë prapë e falënderoj, se tha - jo 70, por 700 dosje çoni në Prokurori dhe s'keni çka më bëni. Po de, këtë po e them edhe unë, domethënë, që e keni kapur shtetin, dhe natyrisht, juve drejtësia nuk ju ndjek. Amnistia nga Prokuroria, ty t'u ka dhënë prej se je ulur në prehër me e Thaçin.

Kjo është e vërteta, këtë po e them unë. Sami Hamiti është ... nga dokumentet e EULEX-it që ka intervenuar jashtëligjshëm për t'i fshehë dëshmitë, për rastin e tij. Kjo është kapja e shtetit, pikërisht për këtë po flasim dhe pikërisht kundër kësaj do të protestojmë.

Çështja tjetër është që a e keni qëndrimin e njëjtë për SHIK-un, siç e keni pasur në vitin 2009, se kurrë nuk po e thoni. Në vitin 2009 keni qenë të ashpër në gjuhën tuaj që e keni përdorur kundër SHIK-ut dhe kundër kapjes së shtetit. A e keni qëndrimin e njëjtë, dhe nëse po, pse nuk po i lejoni deputetët...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Urdhëroni, zëvendëskryeministër i Kosovës, zoti Hashim Thaçi!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar kryeministër, Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Unë vetëm mund ta mbështes fuqishëm deklaratën e kryeministrit Mustafa dhe të rifuqizoj edhe atë që dje e kam deklaruar, edhe sot këtu në Kuvendin e Republikës së Kosovës, natyrisht e rifuqizoj atë që kam deklaruar unë dhe jo atë që dikush mund të ma interpretoj më ndryshe nga deklaratat origjinale.

Si do që të jetë, dua të ritheksoj se sfidat në të cilat ne po kalojmë si shtet i Kosovës, por edhe si institucione si dhe thellimi i partneritetit me bashkësinë ndërkombëtare, janë çështje që kërkojnë edhe trajtim të veçantë, por kërkojnë edhe një përgjegjësi të lartë shtetërore.

Është fat që Kosova e ka një opozitë aktive. Kjo është mirë edhe për koalicionin qeveritar, opozitë më shumë të zhurmshme se sa aktive, më shumë reaguese se sa alternativë, dhe unë ju them nga përvoja ime opozitare, sa më të zhurmshëm dhe reagues do të jeni, po aq më larg pushtetit do të jeni, derisa nuk prezantoni alternativë.

Nuk mund të them që s'e kam provuar, por kur kam prezantuar alternativë, kam fituar, prandaj, këshilla ime sot e parë për ju është kjo dhe nuk është vetëm përvoja ime, por është përvojë e të

gjitha opozitave. Unë e di që edhe PDK, edhe LDK dëshirojnë që të vazhdoni ju kështu, por si do që të jetë, në interes të shtetit, ju për të ndryshuar, më shumë se sa interesat partiake.

Por, u përmendën këtu gjëra, direkt në raport të deklarimeve tona. Përsëri, edhe sot e theksoj se letërkëmbimet që ka ndodhur me aprovimin e plotë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, me Brukselin, sa i përket themelimit të Gjykatës Speciale, është një letërkëmbim i aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe ai letërkëmbim, pastaj ka vazhduar në procedurë duke marrë parasysh kërkesën e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të Kryesisë së Kuvendit dhe dërguar Gjykatës Kushtetuese.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, unë mendoj se e vlerësoj dhe ju ftoj që ta vlerësojmë dhe në të njëjtën kohë duhet ta kuptojmë se nuk duhet që të trajtohet ashtu si pretendohet për t'u prezantuar në opinion si dështim apo ndëshkim për Kosovën, por mendoj se bashkërisht duhet ta shndërrojmë këtë proces në përparësi dhe ecje përpara për Kosovën, për konsolidimin e shtetit, por edhe thellim të partneritetit me SHBA-të dhe Bashkimin Evropian, pra sa i përket themelimit të Gjykatës Speciale.

Në anën tjetër, jemi dëshmitarë edhe të opinioneve të ndryshme që janë të kuptueshme, por theksoj se synimi për t'i goditur institucionet e pavarura të Republikës së Kosovës, është plotësisht i papranueshëm dhe i perealizueshëm për të gjithë.

Gjykata Kushtetuese sot është njëra prej institucioneve më të respektuara edhe prej bashkësisë ndërkombëtare, është një prej institucioneve më të besuara edhe prej qytetarëve të Kosovës. OK. Ju mund të vazhdoni me ritheksimet tuaja të mëhershme, ndërsa në të njëjtën kohë, ju synoni t'i cenoni apo sulmoni edhe sektorin privat të investimeve. Në këtë moment, kur kemi arritur të nënshkruajmë edhe marrëveshjen për Brezovicën, që do të jenë investime deri në 410 milionë euro investitorë ndërkombëtarë, mund të imagjinoni se ndodhin sulme ndaj investitorëve ndërkombëtarë të instaluar në Kosovë, cila do të jetë pamja e Kosovës apo mesazhi i Kosovës për ardhjen e investitorëve ndërkombëtarë në Republikën e Kosovës. Por, edhe mund të imagjinoni në të njëjtën kohë sulmi që ju pretendoni dhe planifikoni t'i vëni bankave të Kosovës. Mendoni se do t'i ulni kamatat e bankave, nëse sulmoni bankat, të jeni të sigurt se do të rritet pasiguria e tyre në Kosovë dhe vetëm mund t'i dëmtoni qytetarët me rritje të kamatave.

Ndërsa, sa i përket sektorit të energjisë, unë dua, të nderuar deputetë, të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës, të theksoj një fakt të cilin ju po e dezinformoni. Kosova, qytetarët e Kosovës, unë po të kisha mundësi edhe ne si Qeveri, krejt falas ia dhënë qytetarëve të Kosovës, rrymën, por qytetarët e Kosovës, sot paguajnë rrymën, parafundit më të lirë në Evropë, jo në rajon, në Evropë. Ky është fakt. Qytetarët e Kosovës, ritheksoj, paguajnë rrymën të parafundit më të lirë në Evropë. Ky është fakt.

Në anën tjetër, ju merreni edhe me mediumet. Unë vetëm dua t'ju them diçka, dhe duhet të jeni të sigurtë kur të flisni me opinion publik, se pastaj po na detyrojnë neve për t'ua thënë gjërat.

Vetëm njëri nga liderët e opozitës i ka 12 anëtarë të familjes të punësuar në Radiotelevizionin e Kosovës. Vetëm njëri nga liderët e opozitës, 12 anëtarë të familjes. Ju e dini shumë mirë. Nëse kërkon, pastaj ua themi edhe emrat.

Ndërsa, sa u përket pretendimeve tuaja për protestë, ne respektojmë opinionet tuaja, respektojmë edhe vullnetin tuaj, nuk ka vend sot në Evropë që nuk ka arsye për të protestuar, pas krizës financiare. Nuk ka vend, e lere më në rajonin tonë. Dhe çdo herë në Kosovë ka pasur arsye, ke mund të gjesësh shkas për të protestuar. Edhe ne kemi qenë opozitë. Si do që të jetë, është e drejtë e juaja, por ajo çka ju ftojme ne është që ne e dimë se diçka tjetër po deklaroni në publik për demonstratë paqësore dhe diçka tjetër po lansoni në terren për përdorimin e dhunës në demonstratë, për realizimin e qëllimeve politike.

Po, po, kjo është e vërteta! Dhe, unë ju ftoj, ju ftoj por në të njëjtën kohë edhe ju konfirmoj se nuk do të mund t'i realizoni qëllimet as me shantazh, e as me ndonjë përpjekje të tipit të revolucioneve. Këtu në Kosovë e përcakton vota e qytetarit se kush qeveris, vullneti i qytetarit, e jo ambicia e dikujt tjetër. Dhe, në anën tjetër, përsëri theksoj se që të tri ju partitë opozitare e dini, se ne këtu jetojmë, shikoni edhe ato shërbimet tuaja represive brendapartiake pastaj flitni për të tjerët. Faleminderit!

KRYETARI: Nenad Rashiqi, pa grup parlamentar, e ka fjalën. Ta kemi parasysh se minutat e ministrave nuk futen në kohën 30-minutëshe të deputetëve.

NENAD RAŠIĆ: Hvala gospodine predsjedniče!

Poštovani premijeru,

Zamenici premijera,

Ministri,

Dame i gospodo,

Narodni poslanici,

Srbi su oduvek bili deo kosovske kulture, vekovni deo i razvoja u svim etapama samog Kosova, ali takođe znate sami da smo više puta bili upotrebljavani, manipulisani za ostvarivanje drugih ciljeva, i kao što je samo Kosovo često puta bilo upotrebljavana više u političke svrhe nego u bilo koje druge razvojnih i ljudske svrhe.

Tako nam se u skoroj historiji, odnosno zadnji put nam se desilo i 8. Juna prošle godine, kada smo imali izbore koje su bile organizovani pod patronatom Kosova, i koji su u nekim određenim sferama dozvolili mogućnost kandidovanja svih mogućih predstavnika. Imali smo opsedanje različitih vrsta autoriteta, koji su bili nadgledači, supersvizori ili posmatrači i različitih evropskih grupacija, različitih evropskih zemalja koji su imali zadatak da u tu našu demokratiju na delu oni sprovode, odnosno uvere se u nju i na takav način saberemo svoje predstavnike.

Na žalost, došlo je do toga i da ti isti predstavnici, ti isti koji su bili posmatrači, u jednom trenutku pogotovo 8. Juna, jednostavno u periodu od posle 3 sati nisu odgovarali na pozive, ili nisu bili tu, i imali smo gde su ljudi, određeni predstavnici određene grupacije, iskoristili taj vakum i upotrebile malverzacije tokom glasanja, i mi sada imamo jedan epilog, u kome imamo praznih peti ili šesti red, gde ljudi koji tobože pregovaraju u ime Srba, apsolutno ne znaju, bar ja ne vidim, ne znaju šta hoće. A to je naša sudbina, to je deo verovatno, koje mi kao Srbi moramo sami da izguramo, ali ja oću da pitam sve vas i jednu drugu stvar, pogotovo pitam moje kolege poslanike, pitam naravno gospodina premijera i zamenika: da li vi kao pozicija, kao većinski deo stanovništva, kao parlamentarna većina, da li vi znate šta hoćete? Da li želite da Srbe, drugi

narod na Kosovu, imate integrisane, ili želite da jednostavno i taj deo koji postoji da dezintegriše?

Ako postoji neki plan, makar bio plan za 2150. Godinu, bar da ga znamo. Ovako ovim tempom, ovo stvarno ne vodi ničemu, i meni je žao što kažem da se ponekad i pitam šta ću...

KRYETARI: Flora Brovina, nga Partia Demokratike e Kosovës. I kemi edhe 10 minuta, apo 8 minuta, ta keni parasysh. Minutat i ministrave janë larguar. Kemi filluar 10:58, Agimi plus 8 minuta tepër.

FLORA BROVINA: Mos m'i merrni minutat, ju lutem!

“J'accuse, j'accuse!”, tha në vitin 1990 eksperti Bernard Benedet, pas kthimit nga Kosova, ku konstatoi se këtu në pranverë të këtij viti ka pasur helmime masive të fëmijëve shqiptarë. “Unë akuzoj”, tha ai në gjuhën e vet.

Në pranverë të këtij viti filloi një luftë e paparë kundër fëmijëve shqiptarë, pas segregacionit dhe aparteidit nëpër shkolla, filloi lufta me helmimet që ndodhën masivisht me helme neorotoksike, helme të luftës.

Nuk u lejua mjekimi i këtyre fëmijëve nga mjekët, nuk u lejuan që ata të drejtohen në institucionet shëndetësore, nuk u lejua që as mjekët t'i mjekojnë këta, përkundrazi ata u ndëshkuan, u dënuan, u përjashtuan nga puna shumë shpejt.

Bota u informua nëpërmjet propagandës policore ushtarake serbe se këta fëmijë janë aktorë.

Bota heshti! A i besoj propagandës serbe, apo deshi të heshtë? Bota edhe sot heshtë për helmimet e fëmijëve, të ndodhura në vitin 1990. Zëri ynë i Kosovës nuk u dëgjua, sepse në atë kohë Kosova ishte një burg i madh.

Kaluan kaq vite, por e vërteta nuk u zbardh asnjëherë. Krimi nuk u dënua. Me mijëra fëmijë, sot të rritur, ende vuajnë nga pasojat e këtij helmi. Milosheviqi nuk e mori akuzën e duhur kundër njerëzimit, nuk e mori akuzën për gjenocid për helmet e kryera kundër 7 860 fëmijëve shqiptarë, në vitin 1990. Ai nuk u dënua fare në Hagë dhe për këtë gabim besoj që duhet ta ketë ndërgjegjen edhe Gjykata Ndërkombëtare e Hagës.

Krimet nuk vjetrohen. Në emër të këtyre fëmijëve, në emër të prindërve të tyre, në emër të pacientëve të mi, unë akuzoj dhe e ngre zërin që të zbardhet krimi për helmimet masive të fëmijëve shqiptarë në Kosovë, të ndodhura në pranverën e vitit 1990.

Kur nuk është vonë të zbardhet kjo e vërtetë, ata ishin...

KRYETARI: Vazhdoja regjia edhe një-dy minuta!

FLORA BROVINA: ...fëmijë, ata ishin fëmijë si të gjithë fëmijët e botës, e dikush ua vodhi fëmijërinë, ua vodhi shëndetin. Dikush deshi t'i vrasë. Pse deshi t'i vrasë? Pse një regjim guxoi

t'i provojë armët kundër njerëzimit dhe të mos ndëshkohet? Pse u hesht kaç gjatë për këtë të vërtetë? Unë akuzoj dhe kërkoj që të zbardhet ky krim, e të dënohet krimineli. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Murat Hoxha e ka fjalën.

MURAT HOXHA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Kryeministër, Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Besoj se e keni informacionin se Federata e Futbollit të Kosovës, respektivisht Komiteti Ekzekutiv, nën udhëheqjen e kryetarit të saj, zotit Fadil Vokrri, është në angazhim të madh që ky sport të jetë pjesë përbërëse e futbollit evropian dhe atij botëror.

Si rezultat i këtyre përpjekjeve dhe gjatë interpretimeve të ndryshme të statutit të UEFA-s dhe FIFA-s është arritur që të lejohet transferimi i futbollistëve nga Republika e Kosovës dhe të mundësohet zhvillimi i lojërave miqësore të ekipeve dhe Përfaqësueses së Kosovës në futboll.

Natyrisht që sporti, në veçanti futboli, e ka edhe elementin, por edhe fuqinë politike. Jemi dëshmitarë të ngjarjeve që ndodhën para dhe gjatë lojës me Përfaqësueset e Shqipërisë dhe Serbisë.

Dua të ju informoj se muajin e kaluar, respektivisht më 24-27 mars, Përfaqësuesja jonë në futboll i zhvilloi dy ndeshje miqësore në Gjermani, më saktë njërën në Frankfurt me FC Eintracht Frankfurt dhe tjetrën në Northont me FC Werder Bremen. Këto dy ngjarje ishin shumë të rëndësishme për bashkëqytetarët tanë në Gjermani dhe për gjermanët dhe, natyrisht, për qytetarët e Kosovës.

Pjesë mbështetëse ishte edhe stafi i Konsullatës së Kosovës në Frankfurt, përkatësisht kryekonsulli Astrit Zemaj dhe stafi i lartë diplomatik, si dhe këshilltari i ministrit për Kulturë, Rini dhe Sport, zoti Faton Peci, të cilët pa dyshim se i dhanë kësaj ngjarjeje frymë të shtetit të Kosovës. Këtë vlerësim e fuqizon edhe më tepër vlerësimi i lartë i punës dhe komunikimet e kësaj konsullate me qytetarët në Diasporë, apo me ata që kanë nevojë për rregullimin e shumë çështjeve të rëndësishme për mirëqenien e tyre.

Të nderuar mërgimtarë nga Kosova dhe qytetarë të Kosovës,

Dua që në emër tuaj, por edhe në bazë të kërkesës suaj, të shpreh shqetësimin për faktin se Radiotelevizioni i Kosovës nuk bërë as më të voglën përpjekje që këto dy ndeshje të transmetohen drejtpërdrejt.

Ky shqetësim është më i madh kur jemi dëshmitarë të emisioneve si “Super Sfida”, në të cilat vetë stafi i RTK-së bën qejf, por edhe emisionet të cilat nuk janë të vlerësuara që do të duhej të ishin pjesë e agjendës së një televizioni publik.

Nuk dua tani të shpjegoj në detaje arsyet pse RTK-ja do të duhej që këtë ngjarje ta shikonte me një përkushtim më të madh, por dua të ritheksoj pse realisht kjo ngjarje si rrallë të tjerat ndërthrin në vete tri elemente ,të cilat do të ishin motiv i madh për transmetim.

Është sporti më përfaqësues dhe më masiv në botë, ishte një lidhje dhe një kontakt qoftë edhe virtual me një numër të madh qytetarësh tanë në Diasporë dhe në Kosovë, e pa dyshim se ishte moment edhe i mbështetjes politike dhe informacioni për Republikën e Kosovës.

Unë shpreh...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ju lutem, regjia, le ta përfundojë.

MURAT HOXHA: Unë shpreh falënderimin për mbështetjen e ish-ministrit të Sportit, por edhe për përkushtimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit aktual të Sportit, angazhimi i të cilëve gjithsesi do të jetë motiv që edhe Televizioni Publik RTK ta ketë një vëmendje edhe një përqendrim më të madh dhe më serioz që t'u mundësojë qytetarëve tanë, përfshirë edhe ata që nuk kanë mundësi të paguajnë, që së paku ta përcjellin Përfaqësuesin tonë në futboll, e cila ka vlera, dhe na jep shpresë që së shpejti të jemi pjesë e integruar e barabartë në futbollin ndërkombëtar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Rexhep Selimi e ka fjalën, le të përgatitet zonja Teuta Haxhiu. Në qoftë se do të kisha mirëkuptimin tuaj, pasi herën e kaluar nuk i kemi pasur 30 minuta, na mbeten vetëm tre të lajmëruar për diskutime, për 9 minuta i mbarojmë, do ta kisha vazhduar edhe për ata tre.

REXHEP SELIMI: Publikimi i listave të veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës veç sa ka vënë në dukje shumë parregullsi dhe probleme që ka Ligji për veteranët.

Po këto probleme janë thelluar edhe me punën jokorrekte gjatë verifikimit nga disa prej atyre që do të duhej së paku të ishin korrektë dhe të përgjegjshëm në procesin e verifikimit.

Në listat e veteranëve të UÇK-së normalisht shohim emrat e luftëtarëve të UÇK-së, heronj të gjallë dhe çlirimtarë të pamposhtur, të cilët me luftën dhe sakrificën e tyre e kanë bërë të mundshme fitoren përball Serbisë okupatore.

E ndërkohë ka edhe shumë prej luftëtarëve që nuk janë përfshirë në këto lista të veteranëve. Aty shteti u ka borxh shumë më shumë se sa një status.

Por, krahas emrave të luftëtarëve, jo diku në luftë, por tash në lista janë rreshtuar edhe emra të tjerë, që nuk kishin të bënin fare me të qenët as luftëtarë, as ushtar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Kështu, në vend që publikimi i listave të veteranëve t'i gëzonte ata, për shumë prej tyre ka sjellë indinjatë dhe revoltë kur emrat e tyre i kanë parë të rreshtuar në të njëjtën listë bashkë me njerëz që ata i quajnë kundërshtarë të luftës së UÇK-së, spiunë e matrapazë.

Por, kjo situatë nuk e ka fillin tash. Për një kohë të gjatë, çështja e veteranëve të luftës u përdor dhe kurrë nuk u zgjidh nga institucionet shtetërore, sidomos nga ata që më së shumti u thirrën në

vlerat e luftës së UÇK-së. Edhe vetë krerët e OVL-së, që tash po heshtin, mbajnë përgjegjësi për këtë situatë, gjithashtu.

Na kujtohet memorandumi i bashkëpunimit në fushatën zgjedhore parlamentare 2014 ndërmjet krerëve të OVL-së dhe kreut të PDK-së, ku së bashku garonin në zgjedhje.

E ndërkohë u themelua edhe Komisioni qeveritar për Verifikimin e Listave të Veteranëve të UÇK-së, ku i pari që e mbushi publikisht aplikacionin ishte kryeministri i atëhershëm, e që në ndërkohë në mediat e huaja deklaronte që në luftë ka qenë larg vijave të frontit.

Ndoshta për këtë mund të themi se ky ishte edhe një inkurajim që të aplikonin sa më shumë njerëz që kanë qenë larg vijave të frontit.

Ata që janë përgjegjës për këtë situatë duhej ta mendonin që një ditë veteranët do ta kuptonin hilen politike. Pakënaqësia e sotme fare lehtë mund të jetë revoltë e nesërme.

Prandaj, unë si deputet, veteran i Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe ne si Grup Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” bashkohemi me shqetësimet e luftëtarëve të UÇK-së.

Për krejt këtë situatë të krijuar i bëjmë përgjegjës të gjithë ata që manipuluan me vlerat e luftës, me të drejtat, me listat dhe me statusin e veteranit të luftës së UÇK-së. Të gjithë deklaruesit e rrejshëm dhe ata që manipuluan me lista dhe status, qoftë të veteranit, qoftë të invalidit, duke përfituar edhe materialisht, duhet të përgjigjen edhe penalisht.

KRYETARI: Atëherë është Teuta Haxhiu, pastaj kanë mbetur edhe Nait Hasani edhe Margarita Kadriu-Ukelli, dhe e përfundojmë.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Për ta nderuar sakrificën edhe martirizimin e të gjitha atyre bashkëqytetarëve, vëllezërve dhe motrave tona, të cilët gjatë vitit 1999 u kidnapuan dhunshëm, u vranë e u zhdukën nga forcat policore e paramilitare serbe, Kuvendi i Kosovës në vitin 2006 e pati shpallur 27 Prillin si dita e të zhdukurve, përkatësisht e të pagjeturve në Kosovë.

Kjo datë ishte zgjedhur, sepse më 27 prill të vitit 1999, në Mejë të Gjakovës ndodhi masakra më e madhe në Kosovë, kur vetëm brenda dy orëve u ndaluan e u ndanë nga familjarët 376 shqiptarë kryesisht nga zona e Rekës së Keqe, për t’u vrarë dhe ekzekutuar mizorisht. Fatkeqësisht, barbarisë së 27 prillit nuk i shpëtoi dot asnjë njeri, mbase edhe për ta dëshmuar krimin e paparë të një aparati të dhunshëm shtetërorë mbi civilë të paarmatosur, burra e gra, pleq e fëmijë.

Po atë ditë ndodhi edhe spastrimi më i madh etnik në ato hapësira, ndërsa të gjitha vendbanimet u dogjën në masën 90%.

Sot, 16 vjet pas ende nuk janë gjetur të gjithë njerëzit dhe familjarët tanë. Në qoftë se institucionalisht u vendos nderimi për ta, pse sot pas 16 vjetëve, pikërisht nga ato institucione nuk bëhet ky nderim.

Të nderuar deputetë,

Familjarët çdo ditë pyesin ku janë e ku mbetën premtimet e Qeverisë për ndërtimin e kompleksit memorial në Mejë, që u premtua pothuajse në të gjitha fushatat elektorale, por asnjëherë nuk u realizua. Ndërtimi i memorialit u premtua edhe herët e pakta kur ktheheshin më 27 prill në Mejë.

Si është e mundur që 16 vjet pas luftës, të gjitha qeveritë në Kosovë nuk ndanë qoftë edhe një cent të vetëm për ndërtimin e këtij kompleksi. E lanë Komunën e Gjakovës të vetmuar e të pamundur në realizimin e këtij obligimi njerëzor e kombëtar. Kush mund ta shpjegojë këtë fakt absurd, që realisht është i dhimbshëm.

Në këtë kuptim, unë sot e kam një pyetje shumë të thjeshtë, krejt konkrete: A e ka në plan Qeveria e Kosovës, kjo qeveri pra, që ndonjëherë ta ndajë një buxhet për ta përfunduar këtë kompleks memorial?

Ndërtimi i këtij kompleksi, i kësaj kujtese të dhimbshme kombëtare, është domosdoshmëri, mbase për njëmijë e një arsyë. Kësaj radhe po e veçoj vetëm një, parandalimin e harresës kolektive, që historikisht na ka kushtuar shumë, e po na kushton edhe sot e kësaj dite. Apo do t'u premtohet edhe këtë vit me avazet e vjetra, nëse eventualisht ndonjëri nga ata e merr guximin të vijë më 27 prill në Mejë.

Dhe, krejt në fund, pse Qeveria e Kosovës nuk po u përgjigjet shqetësimeve...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Të lutem regjia, pas është kah përfundimi.

TEUTA HAXHIU: Pse Qeveria e Kosovës nuk po u përgjigjet shqetësimeve të familjarëve që çështja e të pagjeturve të ngrihet në bisedimet e Brukselit? Pse nuk u zbatuan asnjëherë rekomandimet e interpelancës së mbajtur në këtë Kuvend, në vitin 2012?

Dhe, krejt në fund, dje në Komisionin e të Pagjeturve, nga përfaqësuesi i Departamentit Ligjor u tha që nga përfaqësuesit e Kosovës, nga katër sa janë që bisedojnë për çështje të të pagjeturve, njëri nga ata si lloj eksperti, meqë edhe nuk është ekspert, ende është si përfaqësues i UNMIK-ut. Pra, Qeveria e Kosovës asnjëherë nuk e mori mundin ta heqë nga koka se më nuk ka UNMIK, por edhe sot e kësaj dite e lë një përfaqësues nga UNMIK-u në këtë staf. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete! Vetëm për njoftim të deputetëve për këtë çështje shumë të ndjeshme, Kuvendi i Kosovës, nën patronatin tonë, mban Javën e të Zhdukurve në Kosovë nga data 21-27 prill. Për datën 27 jemi në përgatitje të një seance plenare për të zhdukurit këtu, po në këtë sallë, ta keni parasysh. Faleminderit!

Edhe një memorial të vogël, së bashku me Kryesinë, kemi vendosur që më 27 prill të ngrihet në oborrin e Kuvendit po ashtu për të zhdukurit.

Margarita Kadriu-Ukeli e ka fjalën, të përgatitet Nait Hasani.

MARGARITA KADRIU-UKELI: I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar, tre-katër sa jeni këtu,

Me politikë të inkriminuar, me korrupsion galopant, me institucione dhe administratë të politizuar dhe me drejtësi të kapur nga politika, Kosova nuk mund të ecën në procesin e integritetit evropian.

Shprehjet e aty-këtushme që po i dëgjojmë se Kosova sivjet do t'i liberalizojë vizat, apo se janë plotësuar kriteret, janë vetëm politika ditore për konsum të brendshëm.

Realiteti është krejt ndryshe, këtë e dimë edhe vetë. Nuk mund të jetë dera e hapur për në BE pa dekriminalizimin e shoqërisë. Që nga institucionet e larta e deri tek institucionet më të ulëta, nga drejtësia teri tek politika, të inkriminuarit janë gjithandej.

Nuk luftohet krimi dhe korrupsioni me prokurorë e gjyqtarë që flirtojnë me politikanë dhe s'i ndan as dita, e besa as nata. Një gjë duhet ta kemi të qartë: Kosova nuk do t'i ketë punët mirë për sa kohë tri pushtetet e ndara, Legjislativi, Qeveria dhe Drejtësia do të kenë marrëdhënie të ngrohta.

Kryeprokurori kroat, Dinko Cvitan, deklaroi muajin e kaluar se marrëdhëniet e tij me politikën janë të ftohta. Cvitan tha gjithashtu se ai së bashku me prokurorët e tjerë bëjnë 16 orë punë në ditë për t'i kapur peshqit e mëdhenj dhe të korrumpuar dhe relacioni i tyre prokurorëve ishte punështëpi. Por, ky i nderuar ka futur në burg ish-kryeministrin kroat Ivo Sander, ministra të Kabinetit të tij, kreun e Zagrebit, profesorë të fakulteteve, e shumë e shumë të tjerë. E, vendosja prapa grilave të pushtetarëve të lartë i hapi rrugë Kroacisë për anëtarësim sa më të shpejtë në BE.

Kroacia dikur, si sot Kosova, ishte një vend me korrupsion të lartë, ngjashëm siç ishin edhe Rumania, Bullgaria, të gjitha të pranura sot në BE.

Ndonëse në valët e polarizimit të skajshëm politik, edhe Shqipëria këto ditë i ka hyrë procesit të dekriminalizimit të Kuvendit dhe të politikës, arrestimi i dy deputetëve të mazhorancës është vetëm njëri nga hapat që ajo duhet të bëjë në procesin e dekriminalizimit.

Nuk thotë kot një fjalë popullore “Çka ngjet në fqinjësi, prite edhe në shtëpi”. Andaj sa më shpejt që të dekriminalizohen institucionet e kapura nga shteti, edhe atë nëpërmjet Ligjit për dekriminalizim, aq më shpejt do të hapet perspektiva për qytetarët.

Konsideroj se këtë ligj duhet ta iniciojë me urgjencë Ministria e Drejtësisë, sepse vendi ynë nuk mund të mbetet peng i kriminelëve, i dallaveraxhinjve dhe i korrumpuarve.

Pa largimin e tyre zor se do të shohim ditë të mira, as për vete, e as për të ardhmen e fëmijëve tanë. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Nait Hasani e ka fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Ne në komisionin tonë dhe në Ministrinë e Arsimit e kemi përcjellë një ngjarje mjaftë me rëndësi të Inspektoratit të Arsimit për diplomat false në Pejë Inspektorati i prezantoi shumë gjëra, por nuk nga prezantoi të plota. Tha një kandidat i ka dhënë 17 provime brenda afatit. Ishte befasi. Edhe 155 studentë tha janë pa dosje të shkollimit paraprak. Nuk e di kah kanë ardhur, si janë regjistruar. Por, nuk mjaftoi vetëm kjo.

Në Gjykatën Themelore në Gjakovë e kemi një dosje, ku kanë diplomuar mbi 200 studentë. Ata janë nga komunat e Kosovës edhe vendimin e merr gjykata me përshkrimin absolut të lëndës.

Për atë shkrim absolut të lëndës ne e kemi miratuar një ligj këtu të Kodit Penal dhe ai e njeh të drejtën e mbylljes së rasteve. Do të thotë, ata studentë që kanë diplomuar atje në çfarëdo forme u njihet e drejta e diplomës, e ne tani kemi studentë ose të diplomuar që e kanë kryer shkollën në forma të parregullta.

Njësitë i Hetimeve që e ka bërë në lëndën, e këto janë prej vitit 2001, në vitin 2009 thotë si ka gjetur të gjitha elementet e nevojshme, të cilat tregojnë se të dyshuarit kanë shkaktuar vepra penale të cekura më lartë. Thotë, gjykatësi Shaqir Zika, e nxjerr, thotë kanë kaluar 6 vjet dhe e bëjnë parashkrimin absolut. Tash ne kërkojmë të dimë, a janë këto dokumente ose këto diploma false, a janë të diplomuarit pa asnjë lëndë, ose pa asnjë dokument tjetër apo, fjala popullore, dikush thotë, ka qenë pjesë duke ndrequr shtëpinë atje të një dekani, të një profesori, a ku di unë dhe, atje ata ia kanë parashkruar diplomën dhe ai është tash diku mësues dhe disa kanë ardhur në fakultet në Universitetin e Prishtinës dhe tash bëhen me fakultete dhe doktorë. Dhe, dikur nuk e di ku bëhen, bën vaki edhe ministra bëhen, po nuk e di ajo punë.

Prandaj, neve na duhet të dimë për këto lëndët paraprake, Prokuroria dhe gjyqtarët a kanë ndonjë vendim, a kanë ndonjë rregull, apo veç duhet t'i njohin këto? Mendoj që gjykatësi ka bërë shkelje dhe dikush duhet të merret, sepse lënda është 155/2009 dhe 505/2009 dhe thotë duhet të parashkruhet. Prandaj, gjykatësi Shaqir Zika, ka bërë një shkelje po ashtu, që i ka njohur dhe i njeh këto diploma false dhe këto diploma false sot ne po i vuajmë pasojat, ku kemi prokurorë dhe gjykatës, të cilët janë të pandërgjegjshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Në bazë të nenit 45, paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare zgjat 60 minuta. Për këtë seancë janë parashtruar 33 pyetje parlamentare.

Deputetja Time Kadrijaj ka pyetje për kryeministrin. Deputete, e lëmë në ndërkohë ndoshta vjen kryeministri, apo e bëni pyetjen? Si të vijë, pastaj unë e aktivizoj, ta kemi parasysh.

Deputetja Lirije Kajtazi, pyetje për ministrin Arban Abrashi. A është Arbani, këtu? Dëshiron njësoj të presim, apo... se, ishte Arbani, për atë arsye. E presim!

Deputetja Synavere Rysha, pyetje për ministrin Memli Krasniqi. Urdhëro, deputete!

SYNAVERE RYSHA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër Krasniqi,

Vitin e kaluar sëmundja “gjuha e kaltër” preku shumë vende të Rajonit, fatkeqësisht, nga kjo sëmundje nuk u përjashtua as Kosova. Sëmundja u shfaq në një pjesë të madhe të komunave të vendit. Inspektorët e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës evidentuan raste të fermave, në të cilat ishin shfaqur shenjat klinike të simptomave të sëmundjes “gjuha e kaltër”.

Për këtë janë marrë mostra nga delet, të cilat ishin të infektuara nga ky virus dhe janë dërguar në Prishtinë për analiza të mëtejme dhe nga kjo rezultoi sëmundja të jetë pozitive.

Kjo u solli dëme...

KRYETARI: Deputete Alma, më fal, qëndroni se tani e keni pyetjen. Të lutem, vazhdo!

SYNAVERE RYSHA: Nuk e di pse kjo ndërprerje! Por, sidoqoftë...

KRYETARI: Kërkoj falje, por e pashë, për shkaqe personale, ishte për shkak të gjendjes së saj.

SYNAVERE RYSHA: Kjo u solli dëme të konsiderueshme blegtorëve, sidomos atyre të deleve, si pasojë e kësaj sëmundjeje u ngordhën shumë nga to.

Dhe, pyetja për ju, zoti ministër, a ka nxjerrë Ministria që ju drejtoni, pra Ministria e Bujqësisë, numrin e saktë, se sa kanë qenë dëmet e shkaktuara nga kjo sëmundje, sa dele, por edhe sa kafshë të tjera kanë ngordhur dhe a keni në plan kompensimin e dëmeve të shkaktuara këtyre blegtorëve, kur dihet se ata kanë humbur në masë të madhe bagëtitë e tyre?

KRYETARI: Faleminderit! Deputetë të nderuar, në qoftë se ka mundësi qetësi, për shkak të koncentrimit, do të ishte mirë. E ka fjalën ministri Memli Krasniqi.

MINISTRI MEMLI KRASNIQI: I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

E nderuara zonja deputete Rysha,

Pyetja juaj ka të bëjë me fushën e cila është në përgjegjësi të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, e cila tani për tani nuk është në vartësinë e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, megjithatë, unë kam kërkuar informacione në Agjenci dhe mund t’ua përcjell ato si vijon.

Pas paraqitjes së befasishme të sëmundjes “gjuha e kaltër” gjatë vitit të kaluar, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës ka ndërmarrë hapat e nevojshëm dhe ka bërë përpjekje që këtë sëmundje ta vërë nën kontroll në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me fermerët që kanë raportuar ngordhje të kafshëve apo paraqitje të shenjave klinike të kësaj sëmundjeje.

Duke u bazuar në Ligjin për veterinari dhe në Udhëzimin Administrativ për kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjes “gjuha e kaltër” nga fermat e prekura janë ekzaminuar gjithsej 520 mostra të gjakut, të cilat janë testuar në laboratorin e ushqimit dhe veterinarisë në Prishtinë e njëkohësisht janë dërguar në laboratorin referent të Organizatës Botërore për Shëndetin e Kafshëve, në Institutin për Shëndetin e Kafshëve në Pierbright të Mbretërisë së Bashkuar, me ç’rast është konfirmuar prezenca e kësaj sëmundjeje në Kosovë.

Janë evidentuar 533 raste të ngordhjeve të kafshëve nga sëmundja “gjuha e kaltër”, prej të cilave 525 krerë dele dhe 8 krerë dhi, kurse nuk është evidentuar asnjë rast i ngordhjes së gjedhëve nga kjo sëmundje.

Bazuar në Ligjin për veterinari dhe Udhëzimin Administrativ 28/2006 për kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjes “gjuha e kaltër”, kjo sëmundje nuk konsiderohet si sëmundje zonotike, andaj edhe nuk është e paraparë që të bëhet kompensimi i fermerëve të dëmtuar. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Aida Dërguti.)

KRYESUESJA: A ka pyetje shtesë? Deputetja Alma Lama, ka pyetje për ministrin Mahir Yagcilar.

ALMA LAMA: Faleminderit, zonja kryesuese!

Asociacioni i Arkitektëve të Kosovës, një OJQ me kredibilitet dhe pjesë e asociacioneve ndërkombëtare të së njëjtës fushë, është ankuar për ndërhyrje flagrante në çështje të brendshme të organizatës nga ana e Ministrisë suaj.

Shkeljet nga MAP, respektivisht nga ju si ministër, sekretarit dhe vartësit tuaj janë të shumta, pasi që keni ndërhyrë duke futur masa të dhunshme, për ta tjetërsuar organizatën dhe bartur tek personat, që nuk i përkasin organizatës.

Disa nga shkeljet janë këto:

1. MAP ka ndërhyrë në qeverisjen e brendshme, në kundërshtim me Ligjin për OJQ-të, ka asistuar dokumentet e organizatës dhe nuk i ka zbatuar vendimet e prera të shkallës së dytë, që me Ligjin për OJQ-të dhe ato të procedurës administrative janë përfundimtare.
2. MAP, në kundërshtim me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave zyrtare u ka dhënë të gjithë dokumentacionin organizatës, familjarëve të një ministri të kabinetit të kaluar dhe të tanishëm, duke mundësuar tjetërsimin dhe vjedhjen e identitetit të Organizatës së Arkitektëve.
3. MAP, në kundërshtim me Ligjin për OJQ-të ka organizuar kuvende në emër të Organizatës së Arkitektëve, një shkelje shumë e rëndë kjo.

Prandaj, pyetja ime për ju, zoti ministër, është kjo: Përse MAP ka ndërhyrë në punët e brendshme të Asociacionit të Arkitektëve të Kosovës?

(Ndërprerje e incizimit)

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, e nderuara kryesuese e Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Ministra,

E nderuara deputete Lama,

Ministria e Administratës Publike, Departamenti për OJQ respekton plotësisht autonominë e organizatave joqeveritare. Ato zhvillojnë aktivitetet e tyre, duke përfshirë zgjedhjen e organeve drejtuese dhe ekzekutive.

Në bazë të nënstatutit dhe Ligjit për OJQ, drejtuesit e shoqatave të OJQ-ve nuk emërohen dhe as nuk shkarkohen nga Ministria e Administratës Publike, ose nga departamenti, por nga kuvendet e organizatave joqeveritare, ndërsa, për fondacione këtë të drejtë e kanë bordet.

Edhe në këtë rast, sa i përket Organizatës Joqeveritare Asociacioni i Arkitektëve të Kosovës, kanë pasur probleme të brendshme që janë pasoja të statutit të vjetër, statutit të paqartë dhe disa kërkesave, që Ministria e Administratës Publike, saktësisht Departamenti i OJQ-ve është dashur t'i rregullojë.

Ne si Ministri kërkuam që në qoftë se ekzistojnë afër 200 arkitektë dhe është Asociacioni i Arkitektëve, atëherë ata vetë përmes kuvendit duhet të bëjnë zgjidhjen. Themeluesi të parë të këtij asociacioni janë zoti Sali Salii, Lulëzim Nixha dhe Luljeta Sokoli dhe ndërkohë gjatë këtyre trembëdhjetë ose katërmëdhjetë vjetësh kanë ndodhur edhe disa ndryshime.

Tash dëshiroj të ritheksoj, se ka dalë edhe një problem, sa i përket përfshirjes dhe Asociacionit të Arkitektëve në Ligjin e ndërtimit. Por, në këtë rast, prapë kjo çështje nuk ka rëndësi, rëndësia është që vetë kuvendi i OJQ-së rregullon këto çështje.

KRYESUESJA: Keni pyetje shtesë, deputete?

ALMA LAMA: Faleminderit!

Zoti ministër,

Unë këtu me vete kam një serë dokumentesh, vendimesh, komunikimesh të Ministrisë suaj me asociacionin, shkeljet, e tjerë, e tjerë, që janë bërë në lidhje me këtë çështje që po e trajtoj unë.

Vetëm po ua përmend disa nga shkeljet që ka bërë ministria juaj.

Është shkelur Ligji për lirinë e asociacionit në organizatat joqeveritare, Ligji për shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Kodi i mirësjelljes së nëpunësve civilë, Ligji për procedurën administrative dhe Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në rast se do të kishim më shumë kohë, në këtë pyetje parlamentare unë do t'i citoja të gjitha këto vendime që i kam këtu. Bëhet fjalë për shkelje flagrante dhe ju këtu nuk po e konfirmoni

dhe nuk po e pranoni, që këto shkelje ekzistojnë dhe ka edhe vendime të organeve përkatëse, që kanë konfirmuar shkeljet dhe ju kanë kërkuar juve si Ministri dhe departamentit të OJQ-ve...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Vazhdo, ministër!

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit!

Për këto çështje edhe Komisioni Parlamentar për Administratë Publike ka kërkuar sqarime dhe ne kërkuam me shkrim me disa fakte dhe çështje nga Departamenti i OJQ-ve. Në këtë rast, unë nuk dëshiroj prapë më shumë të ritheksoj, është Kuvendi i Arkitektëve të Kosovës dhe ata me çështje të brendshme, duke u bazuar në statutin, mund të rregullojnë këto çështje.

Në qoftë se kërkohet më tutje, atëherë janë edhe instancat tjera, ku kjo çështja e organizimit mund të rregullohet. Faleminderit!

KRYESUESJA: Deputetja Alma Lama, pyetje për ministrin Mahir Yagcilar.

ALMA LAMA: Faleminderit!

Natyrisht, se e kam marrë me mend se koha nuk do të më mjaftojë, kështu që i kam bërë dy pyetje për të njëjtën çështje.

Asociacioni i Arkitektëve të Kosovës për këtë problem pra, zoti ministër, është ankuar tek institucioni i Avokatit të Popullit në lidhje me shkeljet që ministria që drejtoni ju dhe që e keni drejtuar dhe mandatin e kaluar, ka bërë duke u përzier në punët e brendshme të organizatës.

Kështu, më datë 22 shtator 2014, Institucioni i Avokatit të Popullit ju ka dërguar një ankesë të titulluar, ankesa 237/2014, Valdet Osmani kundër Ministrisë së Administratës Publike, ku preken shkeljet ligjore dhe padrejtësitë që i janë bërë asociacionit dhe ju ka kërkuar zbatimin e vendimeve të formës së prerë të Komisionit për shqyrtimin e ankesave të OJQ-së.

Pra, ky është ai komisioni që ka marrë vendim në kundërshtim, ose me vendime që keni marrë ju dhe Ministria. Pra, ju ka dhënë të drejtë këtyre.

Kështu që, pyetja ime është:

Përse Ministria që drejtoni ju, deri tani nuk i është përgjigjur letrës së Avokatit të Popullit, gjë që e ka obligim, apo jo?

(Ndërprerje e incizimit)

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit!

Edhe në këtë rast unë dëshiroj të ritheksoj, është çështje e arkitektëve dhe është çështje e asociacionit. Sa i përket mos përgjigjes së Avokatit të Popullit, unë sigurisht atëherë e kam kërkuar, por në ndërkohë ka ndodhur mos koordinimi dhe vërtetë që përgjigja nuk është dërguar tek Avokati i Popullit. Por, kjo çështje nuk e ndryshon situatën, sepse është çështje e brendshme

e anëtarëve të Asociacionit të arkitektëve. Edhe kjo çështje është e rregulluar edhe me Ligjin e OJQ-ve, por edhe me ligjet tjera.

Në qoftë se, në proceset administrative Ministria e Administratës Publike nuk mund të ofrojë zgjidhje, ekzistojnë instanca tjera ku mund të drejtohen. Faleminderit!

KRYESUESJA: Deputete, ke pyetje shtesë?

ALMA LAMA: I nderuar ministër,

Shqip po flasim dhe s'po merremi vesh më duket.

Unë po them, që Komisioni për Shqyrtim të Ankesave i ka dhënë të drejtë Asociacionit, ndërkohë, ministria juaj nuk respekton vendimin dhe, madje injoron edhe Avokatin e Popullit.

Vetëm dua të bëj një gjë publike. Nga momenti që unë i kam shtruar këto dy pyetje, kam pasur me dhjetëra ndërhyrje për t'i tërhequr pyetjet, sepse disa mendojnë që unë bëj ndonjë kompromis me krimin dhe nuk e them të vërtetën, por le ta harrojnë.

E di që jeni shqetësuar shumë zyrtarë në Ministrinë tuaj. Unë po ju them, që ju si Ministri po ndërhyni në Asociacionin e Arkitektëve të Kosovës, sepse siç e thatë edhe ju, ky ka shumë ndikim në licencimin e arkitektëve, proces që pritet të fillojë së shpejti.

Dikujt po i intereson licencimi i arkitektëve joprofesionistë dhe matrapazë, në mënyrë që më pas të legjitimohet mafia e ndërtimit. Krejt çështja fle këtu! Ju lutem, mos na hidhni hi syve, sepse i dimë gjërat! Faleminderit!

KRYESUESJA: Vazhdoni, ministër!

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit!

Unë këtë çështje nuk dëshiroj t'i komentoj. Prapë ritheksoj, janë çështje ligjore. Por, sidoqoftë vendimi është te Kuvendi i Arkitektëve, faktikisht asociacioni.

Ndërsa, sa u përket detajeve tjera, unë përafërsisht pyetje e njëjtë ka qenë edhe nga ana e Komisionit dhe është dërguar me shkrim. Ndoshta mund t'i shfrytëzoni ato detaje për ta kuptuar, ndoshta, çështjen si duhet, ose do të ishte, që të rregullohet.

Por, sidoqoftë këto janë procedura administrative dhe pas procedurave administrative edhe ekzistojnë edhe instancat tjera. Faleminderit!

KRYESUESJA: Deputeti Elmi Reçica, pyetje për ministrin Arsim Bajrami.

ELMI REÇICA: Faleminderit, kryesuese!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kam shfrytëzuar të drejtën time që t'i parashtoj një pyetje zotit ministër, që ka të bëjë me themelimin e Universitetit të Shkencave të Aplikuara të Kosovës në Ferizaj.

Pyetja është me sa vijon: Është e ditur që Ferizaj është komuna e tretë më e madhe në Kosovë për nga numri i banorëve, pas Prishtinës dhe Prizrenit. Është qendër shumë e rëndësishme ekonomike dhe strategjike, një nga nyjat kryesore të lëvizjes së mallrave dhe njerëzve.

Që nga viti 1976 ka pasur nisma dhe përpjekje për themelimin e institucioneve të larta arsimore. Në komunën e Ferizajt ka funksionuar Shkolla e Lartë Teknike dhe pastaj avancimi i saj në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara.

Sot në Kosovë ekzistojnë 6 universitete publike, të cilat ofrojnë kryesisht programe të ngjashme të studimit. Për dallim nga universitetet tjera, themelimi i Universitetit të Shkencave të Aplikuara të Kosovës në Ferizaj, do t'i kontribuonte shumë zhvillimit industrial të regjionit të Ferizajt dhe Kosovës në përgjithësi, duke nxjerrë kuadro profesionale të profesionalizuara dhe profilizuara në shkencat e aplikuara, të gatshëm për tregun e punës.

Me themelimin e këtij universiteti do të përfitonin studentë nga komunat, të cilat gravitojnë me Ferizajn, siç janë Lipjani, Shtimja, Kaçaniku, Vitia, Hani i Elezit, Shtërpca dhe Klllokoti. Universiteti i Shkencave të Aplikuara të Kosovës do të ishte institucioni i vetëm i arsimit të lartë në fushën e shkencave të aplikuara në rajon, modern dhe atraktiv për studentët.

Zoti ministër,

Pyetja është kështu: duke e ditur rëndësinë e themelimit të këtij universiteti, çfarë keni bërë ju si ministër lidhur me këtë çështje? Cilat janë veprimet konkrete nga ana juaj, për themelimin e këtij universiteti dhe me çfarë shpejtësie mendoni të lëvizni në këtë drejtim? Faleminderit paraprakisht!

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Faleminderit!

E nderuara kryesuese,

I nderuar zoti deputet Reçica, të falënderoj shumë për pyetjen!

Më lejoni ta informoj Kuvendin për procesin që është duke u zhvilluar brenda Ministrisë së Arsimit rreth këtij projekti, këtij elaborati që tanimë është në Zyrën e Ministrisë së Arsimit. Më tepër se një muaj e gjysmë ne e kemi marrë elaboratin dhe studimin, iniciativën e Fakultetit aktual të Shkencave të Aplikuara që ndodhet brenda Universitetit të Prishtinës.

Dhe, në këtë fushë ne jemi duke zhvilluar dy procese strategjike. Procesi i parë është duke u mbështetur nga Bashkimi Evropian dhe është duke rishikuar komplet sektorin e arsimit të lartë në raport me tregun e punës dhe, jemi duke orientuar universitetet tona publike drejt tregut të punës, drejt specializimit të ngushtë.

Jemi duke zhvilluar me shumë kujdes këtë proces, që universitetet tona të specializohen për fusha të caktuara, që të mos kemi përsëritje të programeve, po që secili universitet të ketë një drejtim të caktuar, për shkak se ne jemi një vend i vogël, kemi një treg të kufizuar të punës dhe nuk mund ta përballojmë një inflacion të kuadrove.

Procesi i dytë, jemi duke orientuar të rinjtë tanë drejt shkencave ekzakto. Jemi duke zhvilluar një projekt, një ekuilibër midis orientimit kah shkencat shoqërore dhe shkencat natyrore. Është projekt i filluar. Kam takuar të gjithë rektorët dhe nga të gjithë kam kërkuar, që të fillojnë

procesin e riorientimit drejt shkencave ekzakte, sepse kemi një numër të madh të të diplomuarve në shkenca humanitare, që po e ngarkojnë tregun e punës.

Në raport me pyetjen tuaj, jemi në fazën finale të shqyrtimit të kërkesës. Kemi marrë mbështetjen e të gjitha partive politike, përmes Komisionit Parlamentar për Arsim, i cili ka qenë, ka vizituar dhe të gjithë përfaqësuesit e këtij Komisioni, nga të gjitha partitë politike e kanë mbështetur këtë iniciativë.

Në Ministrinë e Arsimit është procesi në finalizim. Jemi duke i shikuar standardet akademike për themelimin e Universiteteve. Kërkesat e fakultetit janë modeste, sepse ata nuk kërkojnë një universitet klasik, por një Universitet të Shkencave të Aplikuara, që ndoshta i përgjigjet edhe nevojave të tregut të punës së komunës së Ferizajt, që është komuna e tretë për nga numri i popullsisë.

Të kujtojmë që Ferizaj ka kohë që ka qenë një qytet akademik, ka ofruar drejtime të caktuara. Jemi duke diskutuar me shumë përgjegjësi dhe ne në momentin kur do të kemi një vendim, vendimin do ta sjellim në Parlament për ratifikim.

Dëshirojmë që ky proces të shkojë krejtësisht në baza ligjore, mbi baza të standardeve akademike dhe Ligjit për arsimin e lartë dhe, pastaj është në partitë politike, të cilat tanimë e kanë dhënë dritën e gjelbër. Të gjitha partitë politike, që janë brenda Komisionit për Arsim, që ne me shumë kujdes të vendosim për këtë çështje, në mënyrë që t'i respektojmë kërkesat legjitime të komunitetit atje, por edhe t'i respektojmë tërësisht procedurat akademike.

Unë mendoj, se vetëm Ferizaj ka mbetur një qytet i madh i Kosovës, që ende nuk ka një universitet. Në këtë mënyrë, ne duhet ta mbyllim këtë ciklin e decentralizimit, sepse ju them sinqerisht, po kemi shumë probleme si Ministri, që t'i fusim këto universitetet e reja brenda standardeve akademike, sepse është lehtë të themelosh një universitet, por është vështirë ta mbash me standarde dhe me standarde të cilësisë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Deputet, keni pyetje shtesë?

ELMI REÇICA: Faleminderit, kryesuese!

Desha në radhë të parë ta përgëzoj ministrin Bajrami dhe Ministrinë dhe, njëkohësisht të ritheksoj, që Ferizaj është një nga shtatë qendrat që nuk ka universitet publik dhe, meqë investimet parashihen, dua të them që objekti është i gatshëm dhe nuk do të ketë problem, se Fakulteti i Shkencave të Aplikuara ka mjaft hapësirë që mund t'i absorbojë studentët.

Njëkohësisht me nënshkrimin e djeshëm, ose të pardjeshëm për Qendrën e Brezovicës, realisht mund të prodhohen, ose të dalin kuadro për turizëm dhe hotelieri, ose për forma të tjera të cilat janë shumë të domosdoshme për regjionin. Njëkohësisht, parashihet që të fillojë së ndërtuari edhe spitali regjional, ku mund të parashihen edhe degë, që vërtetë të ketë kuadro edhe për spitalin regjional. Në të ardhmen mendojmë që të fillojë edhe ndërtimi i hidro-sistemit Lepenci, që edhe për aty ka nevojë.

Kështu që, ma merr që është koha që sa më shpejt dhe kisha kërkuar...

(Ndërprerje nga regjia)

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Nuk ishte pyetje shtesë, por më tepër edhe si një konfirmim, që procesi është në fazën finale brenda Ministrisë së Arsimit dhe, jo më larg se brenda dy javësh, ne do të sjellim një vendim i cili pastaj do të marrë ratifikimin. Jemi duke zhvilluar këtë proces me shumë kujdes, sepse bëhet fjalë për një Universitet të Shkencave të Aplikuara, që mund të ketë një, ose dy apo maksimalisht tri drejtime, të cilat nuk përsëriten brenda sektorit të arsimit të lartë.

Do të kemi shumë kujdes, që ky Universitet të mos jetë përsëritje e ndonjë programi, por bashkë do të punojmë pastaj për t'ia siguruar shteti. Na duhet një proces i forcimit kuadror, një proces i akreditimit të programeve dhe jemi mirë me kohë, sepse kemi edhe dy-tre muaj kohë, derisa do të vijë konkursi për gjeneratën e re.

Kështu që jemi duke zhvilluar një proces gjithëpërfshirës, konsultativ. Jemi në kontakt me autoritetet lokale. Unë do ta takoj kryetarin e Komunës së Ferizajt. Do ta marr edhe mendimin e tij, sikur dhe të kryetarëve tjerë të komunave përreth. Dëshirojmë që ta zhvillojmë një proces koncesual, që të shohin vërtetë nevojat e komunitetit, por unë do të kujdesem sidomos, për standardet akademike dhe aspektet ligjore, që ky Universitet që nga fillimi të vendoset në binarë të mbarë.

KRYESUESJA: Deputetja Time Kadrijaj, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetare e Kuvendit!

Meqenëse as kryeministri as ministrat nuk po i pranojnë përgjegjësitë e veta e të vijnë të përgjigjen para deputetëve, ne po parashtrojmë pyetjen.

Në këtë gjendje të rëndë ekonomike, politike, sociale, ku shkak i kësaj ka qenë migrimi i njëqindmijë qytetarëve jashtë vendit, ku kemi gjenerata të tëra të rinjve me shkollim të lartë, qoftë me diploma universitare në vendet e rajonit dhe më gjerë, të cilët janë të papunë dhe presin për punësim, ne kemi zyrtarë të lartë, duke filluar nga kryeministri dhe ministrat, të cilët mbajnë më shumë se dy dhe tri poste. Sa është kjo etike dhe morale?

Dhe, pyetja ka qenë për kryeministrin, sa prej ministrave tuaj kanë më shumë se një vend pune?

Ndërsa, tash së fundi, në raportin e Agjencisë Anti Korrupsion del se 1.509 zyrtarë të lartë kanë më shumë se një vend pune, me 5 funksione janë dhjetë zyrtarë, me katër funksione janë 31 zyrtarë, me tri funksione janë 312 zyrtarë, me dy funksione janë 1 155, që në total janë 1 509 zyrtarë të lartë të shtetit të cilët mbajnë më shumë se dy vende pune, ndërkohë që numri i papunësisë është diku 40% dhe siç thashë ka gjenerata të tëra të cilat me doktoratura presin për një vend pune. Sa është kjo etike dhe sa është ligjore?

KRYESUESJA: Deputeti Shpejtim Bulliqi, pyetje për ministrin Arsim Bajrami.

SHPEJTIM BULLIQI: Faleminderit!

Shumë prej shkollave në nivel të Kosovës, janë në gjendje të mjerueshme për shkak të mungesës së investimeve në objektet e tyre dhe në infrastrukturën përcjellëse. Njëra nga këto shkolla e cila punon në gjendje të mjerueshme është edhe Shkolla fillore “Shefki Kuleta”, paralelja e ndarë në fshatin Halabak, komuna e Podujevës.

Pyetja për zotin ministër, është- Zoti ministër i Arsimit, a mund të na tregoni se në sa objekte shkollore- baraka, sot në tërë Kosovën, zhvillohet mësimi i fëmijëve tanë, dhe cila është politika e juaj që të mund të arrini për t’i futur në prioritet të ndërtimit këto objekte shkollore?

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar deputet Bulliqi, më lejoni të jap përgjigjen.

Ju njoftoj se nga viti 2002, Ministria e Arsimit, në tërë territorin e Kosovës ka ndërtuar 149 objekte shkollore dhe ka rinovuar 55 objekte.

Sa i përket shkollave me konstruksion, barakë apo kontejner nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, përgjatë dy mandateve ka pasur 28 shkolla të tilla dhe përgjatë dy mandateve, numri i këtyre shkollave është zvogëluar në 7.

Pra, në tërë territorin e Republikës së Kosovës, kemi vetëm 7 objekte shkollore në të ashtuquajtura baraka apo kontejnerë, dhe ato janë.

1. Shkolla fillore “Kajtaz Ramadani” në Gollubovc, Malishevë ku ka përfunduar ndërtimi i shkollës së re me investime të komunës dhe tani pritet inventarizimi i shkollës.
2. Shkolla e mesme “Xheladin Deda” në Mitrovicë, e cila është në ndërtim e sipër.
3. Shkolla fillore “Bajram Curri” në Shurdhan, Gjilan e cila po ashtu është në ndërtim e sipër.
4. Shkolla fillore “Shefki Kuleta” në Halabak të komunës së Podujevës.
5. Shkolla fillore “Pjetër Budi” në Babiq të Pejës.
6. Shkolla fillore “Aziz Sulejmani” në Kodër të Mimatorëve në Mitrovicën e veriut, dhe
7. Shkolla fillore “Dituria” në komunën e Kaçanikut.

Meqenëse e përmendët komunën e Podujevës, më lejoni t’ju informoj se Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka ndërtuar 8 objekte shkollore dhe ka rinovuar 3 objekte në vlerë prej 5 milionë e 371 mijë euro.

Gjithashtu në komunën e Podujevës aktualisht me investime të Ministrisë së Arsimit, janë në ndërtim e sipër 2 objekte shkollore, një në Batllavë dhe në Shkollën e mesme në Podujevë.

Sa i përket shkollës në Halabak, është me prioritet të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, për investime, por meqenëse nga komuna e Podujevës i është dhënë përparësi Batllavës, nuk ka mund të përfshihet në buxhetin aktual, për shkak të limiteve buxhetore, prandaj mbetet që këto dy shkolla të përfundojnë sa më shpejt dhe praktikisht të përmirësojnë infrastrukturën në komunë.

Ju lutem po ashtu që të keni parasysh se për ndërtimin e shkollave të reja, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ka edhe kritere për investime, zëvendësimin e shkollave të

amortizuara, të stërvjetruara, largimin e ndërtimit të tretë dhe eliminimin e numrit mbi normën e lejuar.

E tani një informatë që ua kam dhënë edhe në Komisionin parlamentar. Siç e dini, me vendimin tim, ndërtimet e shkollave janë bartur për katër vjetët e ardhshëm tek autoritetet lokale dhe Ministria e Arsimit nuk merret tani me ndërtime të shkollave, ne bëjmë vetëm planifikimin e ndërtimit të shkollave, por kjo komunë bartet te komuna dhe tani veç fondet për ndërtimin e shkollave nga ky vit janë bartur tek Ministria e Administratës Publike. Kjo përkon me politikat tona që të koncentrohemi në standardet e cilësisë dhe mos të humbim asnjë orë, asnjë ditë në ndërtimin e shkollave, sepse nuk kemi si Ministri kapacitete të specializuara të ndërtimeve. Ato janë pranë Ministrisë së Administratës Publike, nga viti i ardhshëm kjo do të jetë tek komunat të cilat në bazë të Ligjit për arsimin para universitar janë përgjegjëse komplet për këtë nivel të arsimit.

KRYESUESJA: Deputet, keni pyetje shtesë?

SHPEJTIM BULLIQI: Zoti ministër, nga kjo çka kuptova, nga përgjigja e juaj po del se 4 shkolla-baraka ende, do të thotë, nuk kanë gjetur mbështetjen tuaj për ndërtimin e tyre. A mund të më thoni saktësisht, që kur mendoni t'i futni në prioritetet këto dhe çështja e bartjes së kësaj kompetence në Ministrinë e Administratës Publike, për mendimin tim është një shtyrje kohe për një vit ose humbje kohe për një vit për arsye kjo Ministri, realisht nuk mund të bëjë asgjë në këtë drejtim kur kihet parasysh fakti që ju jeni ai i cili i dini më së miri problemet e objekteve shkollore në nivel Kosove. Ose, mënyra tjetër më e mirë kishte me qenë që këto kompetenca të barten drejtpërdrejt në nivelin lokal, për arsye se niveli lokal është ai nivel i cili realisht është më së afërmi me qytetarët dhe i dinë më së miri kërkesat dhe nevojat e komunës së tyre.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, deputet Bulliqi!

Arsyet pse sivjet nuk iu ka bartë komunave kompetenca e ndërtimit të shkollave kanë qenë ligjore, sepse ne kemi pasur të votuar një Ligj për buxhetin dhe ka qenë vonë për t'i bërë këto ndërrime, por ne kemi filluar qysh tani brenda kornizës afatmesme të shpenzimeve dhe grandit specifik për t' i bartur direkt dhe nga viti i ardhëm do të jetë. Asnjë shkollë nuk do të pushojë së ndërtuari, sepse MAP-i ka marrë planin e ndërtimit prej Ministrisë së Arsimit dhe atë plan po fillon ta implementojë.

Të mos harrojmë se Qeveria e kaluar ka bërë punë shumë të madhe në ndërtimin e infrastrukturës dhe pozitës materiale të arsimtarëve dhe mund të themi se sa i përket pozitës materiale dhe infrastrukturës në arsim, jemi në mesataren e rajonit. Nuk jemi mbi rajonin, jemi në mesataren e rajonit dhe ne nuk do të pushojmë së investuari në infrastrukturë, në modernizim të shkollave, por prioritet këto katër vjet kemi vendosur cilësinë në arsim, sepse vlerësoj se tani pas kësaj pune që e ka bërë Qeveria e kaluar në ngritjen e pagave, në infrastrukturë është e nevojshme që këto katër vjet aksenti i koncentrimin tonë të jetë në infrastrukturë.

Numri i shkollave - baraka është reduktuar në 4. Të mos harrojmë se pas luftës e kemi pasur të rrënuar komplet sektorin e arsimit dhe tani e kemi prurë brenda standardeve evropiane, por kjo nuk do të thotë se do të pushojmë që shkollat tona t'i bëjmë sa më moderne. Nuk është me rëndësi vetëm të kesh godina, por ato godina t'i kesh funksionale, të informatizuar, t'i kesh me mundësi

të dhënies së mësimi digjital dhe Ministria e Arsimit është duke punuar në projektin e shkollave digjitale. Edhe këto shkolla që i kemi, edhe këto shkolla që i kemi, edhe shkollat model që i kemi, t'i bëjmë shkollat e shekullit 21 dhe ky është një përkushtim i cili po mbështetet fuqishëm nga donatorët, sepse Ministria e Arsimit ka arritur për këta 4 muaj të krijojë konsorciumin e donatorëve dhe ju siguroj se është ndër Ministrinë që më së shumti po mbështet për shkak të prioritetëve që i kemi vendosur rreth standardeve të cilësisë.

KRYESUESJA: Prapë, deputeti Shpejtim Bulliqi, pyetje për ministrin Arsim Bajrami.

SHPEJTIM BULLIQI: Faleminderit!

Në vitin 2009, në komunën e Podujevës ka filluar së ndërtuari një objekt shkollor, në afërsi të Shkollës së mesme të lartë profesionale "Fan S. Noli", që ministri më herët e ceku se është shkollë e mesme, në qytetin e Podujevës.

Tash e 6 vjet me radhë, ky objekt nuk ka përfunduar së ndërtuari. Dhe gjatë vizitave që u realizuan këtyre ditëve në terren, doli se nuk është vetëm në komunën e Podujevës ky rast, por një rast i tillë identik e kishim edhe në komunën e Ferizajt, me po të njëjtin lokal, me të njëjtin projekt, po, edhe në Prizren.

Pyetja ime është për ministrin e Arsimit- Deri në çfarë faze kanë shkuar punimet, tash po them të këtyre objekteve, nuk po them vetëm në Podujevë, por të këtyre objekteve, deri në cilin nivel kanë shkuar punimet, pse është kjo zvarritje gjashtëvjeçare dhe edhe sa kohë duhet zgjatur që i njëjti t'u vihet në dispozicion nxënësve të kësaj komune dhe komunave tjera që i përmenda.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: I nderuar zoti Bulliqi, unë do të përgjigjem për pyetjen konkrete. Uroj që këtë pyetjen shtesë ta bëni që të japim përgjigje adekuate në pyetje.

Ju njoftoj se projekti për ndërtimin e Shkollës së Lartë Profesionale "Fan Noli" në Podujevë është një ndër projektet më të mëdha që është duke u realizuar nga Ministria e Arsimit, me qëllim të përmirësimit të kushteve fizike për mësimdhënie dhe mësimnxënie. Vlera investive e këtij projekti është 2 milionë e 385 mijë dhe ka një sipërfaqe prej 6 500 metra katrorë.

Në këtë objekt shkollor është menduar që mësimin ta ndjekë niveli i mesëm i lartë. Po ashtu objekti shkollor ka 20 dhoma mësimi, laborator dhe sallën e sporteve, që është duke u ndërtuar sipas standardeve me materiale adekuate për ndërtesa shkollore.

Meqenëse Ministria e Arsimit, të Shkencës dhe Teknologjisë, në vitin 2009 ka filluar shumë projekte të kësaj natyre, ju njoftoj se realizimi i tyre është bërë në faza. Gjatë kësaj periudhe është ballafaquar edhe me mungesën buxhetore, gjë e cila ka shkaktuar më vonë edhe kohëzgjatje të afatit të përfundimit të punimeve. Ka pasur vonesa edhe për shkak të vonesave nga operatori ekonomik.

Gjithsesi objekti pritet të përfundojë në vitin 2015, pasi që Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka ndarë mjete buxhetore të nevojshme për përmbylljen e kontratës. Tani niveli i punimit është në fazën finale, pra në realizimin e pozicioneve përfundimtare. Faleminderit!

KRYESUESJA: Deputetë, ke pyetje shtesë?

SHPEJTIM BULLIQI: Zoti ministër, realisht nga kjo që ju po thoni është një planifikim jo i mirë buxhetor që është bërë nga ish ministri, sepse sigurisht ju nuk jeni për këtë çështje, por paraardhësit tuaj. Ose, eventualisht, ka qenë në pyetje periudha e fushatave zgjedhore dhe sigurisht se është dashur me qit sa më shumë projekte që po realizohen dhe kësaj të zvarriten me nga 6 vjet. Sigurisht se rëndësia për këtë objekt shkollor është jashtëzakonisht e madhe dhe unë po them që do të ishte mirë të kryhet sa më shpejt kjo punë, për arsye se ne e dimë që atje është sjell inventari në një objekt që është i pa përfunduar dhe në rast se zvarriten edhe më tutje këto punë, është shumë rrezik që ai inventar që është sjell atje të shkatërrohet e pastaj duhet për të investuar edhe në furnizimin e ri me inventar shkollor. Faleminderit!

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Edhe një herë ju siguroj që objekti do të përfundohet. Është një investim i madh i Qeverisë dhe nuk do të lëmë ne të jetë për pak para ai në gjysmë, por edhe kjo është nga arsyet që ne si Ministri kemi vendosur që ndërtimin e shkollave ta bartim te komunat, sepse kjo merr kohë dhe largon përkushtimin tek reformat në arsim. Një nga arsyet, nuk kemi dashur të humbim kohë në proceset e ndërtimit të infrastrukturës dhe kemi vendosur që kjo çështje nga viti i ardhshëm drejtpërdrejt përgjegjësi e komunës.

KRYESUESJA: Deputet Reçica, meqë ministri Ferid Agani, nuk është këtu. Dëshiron ta lexoni pyetjen? Në rregull! Deputetja Teuta Haxhiu, pyetje për ministrin Arsim Bajrami.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Unë kam dy pyetje dhe më lejoni që të dyja pasi është ministri, njëren pas tjetrës t'i lexoj.

Pra, pyetja e parë ka të bëjë me furnizimin me tekste shkollore të nxënësve shqiptarë në arsimin para universitar në Luginën e Preshevës.

Zoti ministër, a mendoni që në vitin shkollor 2015-2016 do t'i furnizoni me tekste shkollore të gjithë nxënësit e arsimit para universitar shqiptar në Luginën e Preshevës?

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: E nderuara deputete Haxhiu, faleminderit për pyetjen!

Tani është një pyetje me të cilën ne po merremi mbi bazat ditore. Jemi në konsultim permanent me kryetarët e komunave të Luginës së Preshevës. Ministria e Arsimit tanimë ka përfshirë në planin e botimit për këtë vit libra për çdo fëmijë shqiptar të arsimit para universitar. Ju falënderoj edhe juve si Komision që keni qenë dhe keni vizituar dhe i keni parë nevojat. Ju siguroj se jo vetëm tekstet, por edhe mjetet e konkretizimit dhe të gjitha materialet përcjellëse janë duke u përgatitur që ato të jenë të gatshme.

Ne jemi duke punuar edhe në planin politik që kjo gjë të bëhet pa pengesa, sepse nuk dëshirojmë që libri ynë të pengohet. Jemi duke punuar me ministren Edita Tahiri, që kjo çështje të shtrohet si çështje e dialogut, të takohemi dhe në një mënyrë librat atje të çohen në mënyrë solemne, jo në mënyrë klandestine dhe besoj se jemi në rrugë të mirë që një çështje humane ta realizojmë për shkak se ne vlerësojmë që fëmijët tanë janë të diskriminuar, ata nuk kanë tekste, ata nuk e

mësojnë historinë e vërtetë dhe jo vetëm për Luginën e Preshevës, por ne sipas marrëveshjes që e kemi nënshkruar edhe me Republikën e Shqipërisë, jemi duke përgatitur edhe tekstet për diasporën dhe këtë vit do të ketë një mësim të unifikuar midis Kosovës e Shqipërisë, për diasporën dhe ky është një rezultat i mirë, sepse ne si shtet, si Republikë e Kosovës, marrim obligim për ofrimin e mësimin për çdo fëmijë shqiptar kudo që ai jeton.

KRYESUESJA: Deputete, ke pyetje shtesë?

TEUTA HAXHIU: Po! Faleminderit edhe një herë!

Faleminderit, ministër!

Në mënyrë që të kryhet pa pengesa, duhet t'ju rikujtohet edhe një herë edhe në bisedimet në Bruksel, si çështje që është parimore, shkollimi i këtyre fëmijëve të bëhet, do të thotë në mënyrë të njëjtë, të barabartë, sikur që bëhet për komunitetin serb në Kosovë, meqë e dimë që sot e kësaj dite të gjitha shkollat serbe në Kosovë, punojnë me plan-programe të Serbisë, ku shteti serb ndërhyr direkt në shtetin e Kosovës, andaj vetëm t'i furnizojmë këta fëmijë me tekste është më elementare që ne mund ta bëjmë. Pra, e drejta e shkollimit është e drejtë elementare. Prandaj, uroj që viti shkollor t'i gëzojë këta fëmijë pra me furnizimin e teksteve nga klasa e parë deri në klasën e tetë, ashtu sikur që ishin atje. Faleminderit!

KRYESUESJA: Deputeti Nait Hasani, pyetje për ministrin Avdullah Hoti! A doni ta lexoni, meqë ai nuk është i pranishëm?

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetare!

Mua më ka interesuar gjendja në arsim, derisa jeni kryetar Komisioni dhe Komisionit për Arsim i interesojnë vlerat në arsim, gjendja në arsim, angazhimi. Atë që e përmendi profesori Shpejtim për shkollat, janë tri shkolla në Kosovë që kanë mbetur 1 500 nxënës pa e vazhduar shkollimin nëpër ato shkolla, pikërisht diku për 400 000 euro. Dhe kjo është gjë e tmerrshme nëse sot na diskutojmë për 1 500 nxënës që ata s'munden vitin shkollor 2015 në shtator ta fillojnë për këto para. Prandaj, Qeveria do të gjejë para, do të gjejë burim dhe duhet të fillojë në Prizren, në Ferizaj dhe në Podujevë.

Çështja që unë e kam bërë pyetjen ministrit të Financave, është gjendja po ashtu në arsim është e rëndë dhe arsimit financohet nga shteti. Derisa arsimit financohet nga shteti, pyetja ime ka qenë a ka shkolla private që i financon shteti mësimdhënësit? Unë mendoj se ka, prandaj kërkoj përgjigje nga ministri, dhe jo nga ministri i Arsimit, por nga ministri i Financave. Faleminderit!

KRYESUESJA: Deputeti Faton Topalli, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa. Dëshironi ta lexoni pyetjen Faton?

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesuese!

U tha nga të dy kryeministrat që problemet të zgjidhen në mënyrë institucionale. Unë kisha një pyetje institucionale për kryeministrin, por as njëri e as tjetri nuk është këtu, mungojnë sepse nuk e njohin rrugën institucionale.

Pyetja ime ka të bëjë me dy afëra korrupsioni në Ministrinë e Punëve të Brendshme, njëra në kohën e ish-kryeministrit dhe tjetra në kohën e tashme të këtij kryeministri.

Meqë po shihet se shteti, respektivisht kapja e shtetit e ka emrin Hashim Thaçi dhe Isa Mustafa, pyetjen time parlamentare do ta shtroj më 18 prill në protestë dhe në qoftë se në protestë nuk përgjigjet kryeministri, do ta shtrojë prapë në seancën e ardhshme.

Unë i ftoj të gjithë qytetarët që kanë pyetje të ngjashme për kryeministrin dhe Qeverinë, që nuk janë këtu edhe kur na duhen neve, të vijnë më 18 prill dhe atje pastaj t'i shtrojmë kërkesat të cilat qytetarët mendojnë duhet t'u përgjigjet Qeveria. Faleminderit!

KRYESUESJA: Deputeti Armend Zemaj, keni pyetje për ministrin Ferid Agani, i cili nuk gjendet këtu. A doni ta lexoni pyetjen?

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesuese!

Pyetjen do ta lexoj, sepse edhe ashtu është një problem në vazhdimësi që ndodh me degradimin e ambientit në komunën e Deçanit. Çështja është konkrete, është shkatërrimi i ambientit në Grykën e Deçanit, si rrjedhojë e fillimit të ndërtimit të tri hidrocentraleve nga kompania fituese e cila me të madhe ka degraduar shtratin e lumit Lumëbardhë, apo siç njihet në popull Bistrica e Deçanit, duke e larguar masën drunore përgjatë këtij lumi dhe duke krijuar zona erozive si dhe ekspluatuar me mijëra metra kub rërë dhe zhavorr, e cila ka bërë që shtrati i këtij lumi të humbë naturalitetin e vet që posedon.

Unë kam menduar se sot do të vjen ministri dhe do të përgjigjet. Nuk e di ky personalisht a është në dijeni dhe a kanë filluar ndonjë masë preventive sipas ligjeve dhe kontratës me këtë operator dhe ky është një shqetësim i vazhdueshëm i banorëve të qytetit të Deçanit, për shkatërrimin e këtij ambienti para syve të institucioneve lokale dhe qendrore.

Ne të gjithë e dimë se ajo zonë është e mbrojtur me Ligjin për zonën e mbrojtur, diku 800 hektarë tokë rreth Manastirit të Deçanit dhe është kërkuar e aprovuar në atë kohë si interes vital i qytetarëve të atij vendi, por nga kjo del se në këtë aspekt është interes klientilist i një grupi të caktuar dhe nuk ka asgjë të bëjë me mbrojtjen dhe investimet që bëhen për hir të interesave të qytetarëve.

Për qytetarët e Deçanit, çudia më e madhe është se si është e mundur të lejohet që sasia më e madhe e ujit të Lumëbardhit të futet nëpër gypa dhe duke bërë që shtrati i këtij lumi, sidomos verës do mbetet i shkretë pa sasi të mjaftuar uji. Edhe sot kur në atë pjesë në bjeshkë është 1 metër borë, Deçani...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Deputeti Zemaj, keni pyetje edhe për ministrin Avdullah Hoti. A doni ta lexoni?

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesuese!

Desha vetëm ta përfundoj pyetjen e parë dhe ta citoj një pjesë të Ligjit për mbrojtje të ambientit.

Ligji i Republikës së Kosovës, për zonat e veçanta të mbrojtura, i aprovuar me 20 shkurt 2005, neni 5 thotë: “Aktiviteti i ri në fushat e mëposhtme do të ndalohen: ndërtimet apo zhvillimet industriale të tilla si eksplorimi dhe dëmtimi i burimeve minerale, ndërtimi i digave, centraleve

apo linjave të tensionit, furrave dhe fabrikave dhe zhvillimet që çojnë në shpyllëzimin apo ndotjen e ambientit”.

Unë sot kam pasur edhe disa fotografi këtu me veti, të cilat tregojnë se çfarë shkatërrimi po i bëhet asaj pjese dhe atij ambienti të bukur dhe i cili është duke e lënë qytetin e Deçanit edhe pa ujë të pijshëm.

Pyetja për ministrin Avdullah Hoti ka të bëjë po ashtu me mbrojtje të ambientit dhe që ka të bëjë me regjistrimin e automjeteve i cili i paraprinë një taksë për mbrojtjen e mjedisit në Republikën e Kosovës. Asnjëherë nuk është thënë se ekziston një fond i tillë, ku shkon ky fond, si shfrytëzohet dhe si u rikthehet qytetarëve të vendit për mbrojtjen e atyre qëllimeve që ne mendojmë se është dashur të menaxhohet një bord i veçantë, i cili do t'i dedikonte këto të holla për shërim të qytetarëve të sëmurë si pasojë e ndotjes së ambientit, pastaj për pajisjen e laboratorëve të cilët e monitorojnë ndotjen e ambientit.

Gjithashtu nga ky fond do të duhej të bëhej blerja e barnave për familjet në asistencë sociale, arsimimin e kuadrove për mbrojtjen e mjedisit, organizimin e konferencave, simpoziumeve për ruajtjen e mjedisit, vetëdijesimin e qytetarëve për mjedis të pastër si dhe për projekte të ndryshme mjedisore.

Besoj se këto dy pyetje do të hasin në veshët e këtyre dy ministrave apo të stafit të tyre dhe të mos vazhdojnë me të njëjtën agjendë, e para që ka të bëjë me shkatërrimin...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Deputetja Luljeta Veselaj-Gutaj, pyetje për ministrin Arsim Bajrami.

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Faleminderit, kryesuese!

Çështja është e ngritur si shqetësim që në kohët e fundit vjen në lidhje me gradat apo titujt e fituar pas diplomimit në arsimin e lartë. Studentët të cilët kanë përfunduar studimet në sistemin katërvjeçar dhe studimet postdiplomike në arsimin e lartë dyvjeçar, po ashtu edhe studentët të cilët kanë përfunduar studimet në sistemin trevjeçar dhe studimet postdiplomike në sistemin dyvjeçar apo edhe njëvjeçar, nuk ka ndonjë dallim në këtë sistem që merren diplomat apo titujt shkencorë për këta studentë- titulli është i njëjtë - master.

Zoti ministër, a është specifikuar diku që titulli shkencor të dallojë nga sistemi 4+2 me studimet postdiplomike dhe të sistemi 3+2 apo edhe 4+1 dhe 3+1? Të gjithë këta studentë marrin gradën apo titullin e njëjtë.

Për ndryshim nga ne, në vendet e ndryshme ne e dimë që marrin grada të ndryshme. Faleminderit!

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Faleminderit e nderuara deputete Veselaj dhe të falënderoj që e ke ngrehur këtë çështje, që është preokupim i shumë studentëve, sidomos të atyre të studimeve pasdiplomike.

Më lejoni t'ju informoj që Ministria e Arsimit tani ka miratuar udhëzimin për barasvlerën e numrit të kredive dhe ne jemi pjesë e procesit të Bolonjës dhe një nga shtyllat e procesit të Bolonjës, është sistemi evropian i kredive, çka do të thotë se tanimë kemi të instaluar sistemin e parë të studimeve universitare, të ashtuquajtura studime bachelor që përfundojnë me 180 kredi.

Në fakultetet që janë katërvjeçare, e janë disa katërvjeçare, sepse e lejon këtë Bolonja, kemi me 240 kredi. Çdo kund titulli master sot fitohet me 300 kredi. Çka do të thotë? Nëse studentët kanë kryer programin trevjeçar ata duhet të kenë një master dyvjeçar që të mbërrijnë tek pesë vjet apo te 300 kredi. Për studentët katërvjeçar masteri zgjat 1 vit dhe ata duhet të kenë plus 60 kredi. Në momentin kur mbërrijnë në 300 kredi ata marrin gradën master.

Aktualisht në Kosovë nuk ka më gradë shkencore - magjistër i shkencave. Ka vetëm gradë master, sepse ky është sistem i Bolonjës. Dhe, siç e dini, niveli i tretë është 480 kredi, që do të thotë arritja e gradës së doktorit të shkencave.

Ne jemi duke punuar tani që të bëhemi pjesë fuqplotë e procesit të Bolonjës, që të pranohejmë në hapësirën evropiane, që këto kredi t'i transferojmë në Evropë. E kemi krijuar marrëveshjen me Shqipërinë që këto të jenë transperueshme dhe besoj që nuk është njëjtë si ta kesh një fakultet trevjeçar si katërvjeçar, sepse ata që janë me katër vjet marrin master njëvjeçar, u duhen edhe 60 kredi. Ata që janë trevjeçar duhet të hyjnë në një program me 120 kredi. Siç e dini, ne e kemi gjeneratën e parë në shkollën e doktoraturës dhe kemi dy lloj studentë në doktoraturë, studentë që kanë magjistraturë dhe studentë që master. Studentë që kanë magjistraturë kanë startuar menjëherë me 300 kredi dhe ata i kanë disa përparësi.

Ju siguroj se ekzistojnë udhëzimet administrative dhe me kujdes jemi duke e diskutuar këtë çështje që absolutisht studentët të mos dëmtohen.

KRYESUESJA: Deputete, keni pyetje shtesë?

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Pyetja shtesë është: A jeni të informuar që në bordet e Ministrisë së Arsimit për shembull studentët apo ligjëruesit, të cilët i kanë përfunduar studimet katërvjeçare dhe studimet posdiplomike dyvjeçare, që e kanë titullin master, dhe kolegët e tyre të cilët i kanë përfunduar po të njëjtat vite të studimeve në Universitetin e Tetovës e kanë titullin magjistër. Kur në programin e AKM-së në të drejtën e udhëheqjes së temave të diplomës u bëhet diskriminim ndaj ligjëruesve, të cilët i kanë përfunduar studimet posdiplomike në Kosovë, në krahasim me ata të cilët i kanë përfunduar po të njëjta vite të studimit dhe në fushën e njëjtë në Maqedoni për arsye se në diplomat e tyre u shkruan magjistër.

Zoti ministër, a jeni të informuar për këtë çështje?

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: E nderuara deputete, Jam shumë miri i informuar dhe shumë i familjarizuar me këtë çështje. Është një periudhë tranzicioni, sepse aktualisht asnjë universitet, asnjë fakultet, nuk jep gradë të magjistratit. E japin vetëm gradën e masterit dhe profesorët e universitetit që janë këtu e dinë.

Në periudhën transitore derisa kemi ende me gradën magjistër, ose në proces mësimor, këta kanë përparësi se startojnë me numrin e kredive të mjaftueshëm dhe kalojnë menjëherë në vitin e dytë në doktoraturë, sepse u njihen kreditë.

Sa i përket universiteteve, që i përmende të rajonit, secili shtet e ka sistemin e vet të arsimit të lartë. Nëpërmjet qendrës për nostrifikim për njohje dhe barasvlerë dhe ne bëjmë njohjen e barasvlerën dhe bartjen e kredive sipas kornizës ligjore që ne e kemi në fuqi.

KRYESUESJA: Deputetja Njomza Emini, pyetje për ministrin Ferid Agani. Deputetja Shqipe Pantina, pyetje për ministrin Mahir Yagcilar. Nuk është! Deputeti Pal Lekaj, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa. Nuk është! Deputeti Daut Haradina, pyetje për ministrin Skender Hyseni. Deputeti Daut Haradinaj, përsëri pyetje për ministrin. Ok-ej! Deputetja Xhevahire Izmaqu, pyetje për ministrin Arsim Bajrami.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, nënkryetare!

Të nderuar ministra,

Të respektuar kolegë deputetë,

Si duket, sot e paskemi shumë të saktë ministrin Bajrami, por unë fillimisht e falënderoj për të gjitha përgjigjet që i dha në këto pyetje, sepse morëm informacione me të vërtetë të nevojshme për proceset e mira novative në ngritje të cilësisë në arsim.

I nderuar ministër,

Unë e kam një çështje specifike. Viteve të fundit e kemi një numër të konsiderueshëm të studentëve nga Kosova, të cilët studiojnë jashtë dhe vijnë në të gjitha nivelet e arsimit të lartë, qoftë duke shkuar në mënyrë individuale, apo nëpërmjet formave të bursave të ndryshme dhe në momentin kur ata kthehen në Kosovë e kanë nevojën e vlerësimit edhe të njohjes së diplomës nëpërmjet procesit pra që ecën nëpër qendrën “NARIC”.

I kemi disa ankesa se këtu ka një vonesë në kthimin e përgjigjeve këtyre studentëve. Fillimisht, duke mos e njohur krejt procedurën, kam menduar që është problematike e stafit administrativ, por, siç duke, nuk ishte vetëm problem procedura të stafit, mirëpo këtu kemi edhe ngathtësi, ndoshta edhe neglizhencë të ekspertëve të cilët janë të angazhuar nga ministria në fusha të ndryshme dhe ata kanë detyrim të kthejnë përgjigje për nivelin, apo për gradën shkencore të aplikuesve.

I nderuar ministër,

A jeni në dijeni, sepse e di që keni shumë punë dhe ndoshta ende s’keni filluar në këtë drejtim, çka mendoni që mund të ndërmerrni që procedurat të mos jenë kaq të ngathëta dhe të ketë përgjigje në afatin ligjor. Faleminderit!

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: E nderuara deputete,

Ju falënderoj për pyetjen,

E keni shtruar një pyetje shumë të rëndësishme rreth njohjes së barasvlerës së diplomave.

Në Ministrinë e Arsimit ekziston qendra “NARIC”, që është një qendër ndërkombëtare, e cila merret me njohjen, barasvlerën dhe nostrifikimin e diplomave.

Dhe, dua të ju informoj se çfarë unë kam bërë që kjo qendër të bëhet shumë më funksionale dhe të mos përsëriten gjërat që ju i theksuat, me shumicën prej të cilave edhe pajtohem.

E para, e kemi krijuar Këshillin e ri kombëtar për njohje, një organ profesional që është formuar nga ekspertët më të mirë për njohje.

E dyta, veç e kemi siguruar platformën elektronike të të gjitha diplomave që presin për njohje, barasvlerë.

Dhe, e treta, e kemi krijuar një sistem jashtëzakonisht efektiv e të shpejtë që asnjë kandidat të mos pësojë nga zvarritja e këtyre procedurave.

Jemi duke e krijuar një sistem funksional, që praktikisht çdo diplomë të barasvlerësohet dhe të njihet në një afat normal brenda rregullave të ligjit për procedurën e përgjithshme administrative.

Kemi siguruar lehtësira sa i përket njohjes së diplomave nga Republika e Serbisë. Njëra nga marrëveshjet që e kemi nënshkruar në mbledhjen e përbashkët të dy qeverive është edhe kjo dhe kemi vendosur që cilado diplomë që njihet nga një autoritet ligjor i Shqipërisë do të njihet automatikisht edhe në Kosovë. Kjo sidomos vlen për universitetet publike, ku më së paku që mund të bëjmë për ta liberalizuar tregun.

Kemi pak problem me diplomat që vijnë nga shtetet që s'ë kanë njohur Republikën e Kosovës. Këtu kemi disa ngecje, sepse nuk na përgjigjen me kohë, kemi pak problem me Republikën e Maqedonisë ku ende komunikojmë me nota diplomatike, nuk e kemi një komunikim të përditshëm, por ju premtoj dhe ju siguroj se qendra për njohje, e njohur me shkurtesën "NARIC", do të jetë një qendër efektive. Do të mundohemi ta bëjmë model në rajon, një qendër që ofron shërbime të shpejta dhe asnjë student të mos pësojë, qoftë për punësim, qoftë në karrierë për shkak të pritjes në këtë qendër.

KRYESUESJA: Pyetje shtesë, deputete?

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, e nderuara nënkryetare!

Faleminderit, ministër!

Besoj që përgjigjet me të vërtetë do të jenë shumë të mirëseardhura për shumë studentë të cilët ndoshta më shumë kanë pritur për nostrifikim se sa mandatin komplet të përfundimit të studimeve.

Mirëpo, unë edhe një herë ju drejtohem me pyetje. Ju duhet t'i shikoni edhe një herë ekspertët të cilët janë të angazhuar, nuk po them gjatë kësaj kohe, sepse është shumë e shkurtër prej kur jeni vendosur ju, mirëpo ekspertë të ndryshëm të fushave të ndryshme, të cilët fillimisht e kanë për obligim ta shikojnë vlerën, gradën shkencore të aplikuesit. Nëse ata nuk i përgjigjen ministrisë për një kohë të gjatë, nuk janë në vendin kur i fton në "NARIC", a mund ta ndërmerri një masë që ata të ndërrohen, thjesht nëse ka të tillë. Faleminderit!

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Edhe një herë po e theksoj, hapi i parë e kemi formua Këshillin kombëtar për njohje, të përbërë nga ekspertët më të mirë që i ka Kosova. Keni të drejtë,

procedurat janë zvarritur te komisionet e fakulteteve, ku padrejtësisht lëndët kanë ndenjur ndoshta edhe nga një, dy e tre muaj e nuk është shkrua recensionin. Çfarë kemi bërë? Në të gjitha fakultetet jemi duke i themeluar komisionet e reja, jemi duke ua përkujtuar se ata i kanë vetëm 60 ditë kohë në bazë të Ligjit për procedurën administrative dhe jemi të kujdesshëm që nëse një profesor brenda 60 ditësh nuk e shkruan një recension për njohje të diplomës, ai nuk do të jetë asnjëherë në asnjë komision recensues.

Ju siguroj që është duke u vendosur një rend dhe rregull te njohja e diplomave, sepse ka qenë krejtësisht e padrejtë që dikush nuk ka mundur të konkurrojë për asistent, apo të punësohet, sepse i është zvarritur njohja e diplomës dhe ne po krijojmë një procesim elektronik të procesit të nostrifikimit të diplomave në Republikën e Kosovës.

KRYESUESJA: Deputeti Bekim Haxhiu, pyetje për ministrin Imet Rrahmani.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, e nderuara kryesuese!

Edhe pse ministri nuk është këtu, e pyetjen e kam parashtruar që një kohë, mendoj që është në interesin edhe të vetë ministrisë, por edhe qytetarëve që kjo pyetje të parashtrohet këtu.

Në muajin nëntor 2014 është nënshkruar marrëveshja ndërmjet Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës dhe Qendrës Spitalore Klinike Universitare të Tiranës për ofrimin e shërbimeve të kardiokirurgjisë nga ekspertët e QSKUT-së në kuadër të shërbimit të kardiokirurgjisë në QKUK.

Jam bërë më shumë se pesë muaj nga nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje dhe opinioni publik e as ne nuk jemi njoftuar me detajet e saj, me koston e saj, me implementimin, sepse në praktikë nuk po vërehet se është duke u parë zbatimi i kësaj marrëveshjeje, ngase pacientët vazhdojnë të referohen në sektorin privat me buxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë.

Pas arritjes së marrëveshjes dhe furnizimit me stenta dhe material tjetër shpenzues për kardiokirurgji dhe kardiologji invazive është llogaritur se është kompletuar ofrimi i këtij shërbimi në sektorin publik.

Mirëpo, me gjithë këtë, pacientët vazhdojnë të referohen në sektorin privat pas orës 15:00 të pasdites dhe këtu kemi edhe një pabarazi në ofrimin e shërbimeve mjekësore dhe një shpenzim të Buxhetit të Kosovës në tri forma për ofrimin e një shërbimi.

Bazuar në Ligjin numër 04/L-125 për shëndetësi, neni 24, referimi në institucione tjera shëndetësore bëhet në rastet kur institucioni publik nuk është në gjendje ta ofrojë kujdesin e duhur shëndetësor brenda fushëveprimit të tij. Ndërsa ne e kemi kompletuar ofrimin e këtij shërbimi në kuadër të kardiokirurgjisë dhe kardiologjisë kanë investuar miliona euro për ofrimin e këtyre shërbimeve dhe me gjithë këtë, ministri Rrahmani vazhdon të nënshkruajë që këta pacientë të trajtohen në sektorin privat. Dhe, këtu e kemi një shkelje të ligjit, përkatësisht të nenit 24 të Ligjit për shëndetësi.

Prandaj, kërkesa ime është që ministria ose të heqë dorë nga ajo e cila deklarohet se ka përgatitur dhe e ka furnizuar QKUK-në...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Deputeti Bekim Haxhiu, pyetje për ministrin Arban Abrashin.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryesuese!

Pasi e kemi atë mundësinë e kohës shtesë, besoj që na jep se është minutë jona edhe ajo tjetra, nëse nuk arrij ta kompletoj pyetjen. Faleminderit!

Ministri Abrashi ishte këtu më herët dhe mendoj që do të jetë në interesin e tij ta dëgjojë edhe këtë pyetje.

Shumica e të punësuarve në sektorin privat punojnë pa kontrata pune, me orar të zgjatur punës pa të drejtë për pushimi ditor, pushim javor ose vjetor, pa kompensim për punët jashtë orarit, pa sigurim në punë, pa pajisje mbrojtëse.

Shkelja e të drejtave të punëtorëve është më e theksuar në sektorin privat, por shkeljet e të drejtave të tyre janë evidente edhe në sektorin publik, ku punëdhënësit abuzojnë me ligjin.

Me kapacitetet që posedon Inspektorati i Punës po bëhen përpjekje për monitorimin e respektimit të të drejtave të punëtorëve, prandaj implementimi i Ligjit të punës mbetet një sfidë e vërtetë për institucionet vendore.

Rastet abuzive, shkelja dhe pasiguria në punë janë bërë edhe në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, që është themeluar nga Kuvendi i Kosovës dhe ndërmarrjet shoqërore që menaxhohen nga AKP-ja dhe ato të privatizuar nga AKP-ja. Pyetja për ministrin ishte: Sa inspektime e monitorime ka bërë Inspektorati i Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe në ndërmarrjet shoqërore që ka në menaxhim AKP-ja dhe ato që i ka privatizuar? Cilat janë të gjeturat e Inspektoratit të Punës në ndërmarrjet shoqërore që menaxhohen nga AKP-ja dhe cilat masa janë ndërmarrë? Sa po respektohen dhe zbatohen vendimet e Inspektoratit të Punës në zbatimin e të drejtave të punëtorëve kur kemi raste të shkeljeve nga punëdhënësit? Çfarë veprimesh janë ndërmarrë për zbatimin e vendimeve të Inspektorit të Punës? AKP-ja, siç quhen të dhënat e deritanishme, punëtorët e fabrikës së punëtorëve të Fabrikës së Lllamarinës “Lamkos” në Vushtrri, apo ata të “Trepçës”, ku sjellja e menaxhmentit të AKP-së është një sjellje prej pashallarëve, ndërsa ajo e drejtorëve të këtyre ndërmarrjeve shoqërore dhe atyre të privatizuar prej bejlerëve, ndërsa punëtorët trajtohen si shegertë.

KRYESUESJA: Deputetja Teuta Haxhiu, pyetje për ministrin Arsim Bajrami.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetare!

Pyetja e dytë është kjo: Rikualifikimi i mësimdhënësve të Luginës së Preshevës.

Zoti ministër,

Çfarë po mendoni ju si ministër i Arsimit të Republikës së Kosovës të bëni për rikualifikimin e mësimdhënësve të Luginës së Preshevës, të cilët e kanë përfunduar Shkollën e Lartë Pedagogjike.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Faleminderit! Kjo është pyetja e fundit për arsim. Më lejoni t'jua jap përgjigjen, e respektuara deputete Haxhiu.

Fillimisht nuk bëhet fjalë për rikualifikimin, por për avancimin e kualifikimeve të mësimdhënësve. Është fjala për mësimdhënësit e Shkollës së Lartë Pedagogjike.

Dëshiroj të ju theksoj se të gjithë kandidatët e Luginës së Preshevës që kanë pasur dëshirë të aplikojnë në këtë program të avancimit të kualifikimeve janë përfshirë.

Tani i kemi pasur 20 arsimtarë të Luginës që e kanë ndjekur këtë program në Gjilan, që është më afër tyre, dhe asnjë kërkesë që ka ardhur nga mësuesit e Luginës nuk është refuzuar. Për çdonjërin kemi ofruar program njëvjeçar për arritjen e gradës bachelor, apo për arritjen e numrit prej 180 kredive sa kërkohen në vendin e tyre të punës.

Ne jemi të hapur që në bazë kërkesave që na vijnë nga këto komuna ta aranzhojmë edhe një vit edhe një program shtesë, edhe pse ju them se ky vit përfundon këtë vit, por jemi të gatshëm si ministri të gjejmë buxhet, të gjejmë mjete, të gjejmë mësimdhënës që ta ofrojmë edhe një vit apo edhe dy vjet, sa të ketë nevojë, për avancimin e mësimdhënësve të Luginës së Preshevës, sepse një numër i madh i mësuesve atje anë me Shkollë të Lartë Pedagogjike. Ata nuk janë me sistemin e Bolonjës 3+1 apo 4+1, prandaj jemi të gatshëm t'i akordojmë edhe një vit, edhe dy vjet, sa të ka nevojë për programe shtesë, në mënyrë që secili mësues i Luginës së Preshevës t'i avancojë kualifikimet dhe t'i plotësojë edhe standardet që parasheh ligji serb për punëtorët e arsimit parauniversitar.

KRYESUESJA: Pyetje shtesë?

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, ministër!

Pra, unë nga këtu ju bëjë thirrje të gjithë atyre mësimdhënësve, të cilët shqetësimet e tyre na i tha ne si anëtarë të komisionit në takimin që e patëm, dhe kërkuan edhe kryetarët e komunave që t'u mundësohet një gjë e tillë atyre mësimdhënësve. U bëjë thirrje që të gjithëve pra se Qeveria e Kosovës është e gatshme ta përmbushë këtë premtim. Faleminderit!

KRYESUESJA: Të nderuar deputetë, koha për pyetje parlamentare ka kaluar. I kemi edhe tetë pyetje, por asnjëri nga ministrat të cilëve ju drejtohen këto pyetje nuk janë të pranishëm.

Nëse doni, vazhdojmë t'i lexojmë këto pyetje për ata që duan.

Atëherë vazhdojmë me rendin e ditës. Pyetjet e deputetëve që nuk marrin përgjigje në dy seanca plenare, ato do të publikohen në revistën e Kuvendit dhe në faqen zyrtare elektronike të Kuvendit, kurse Zyra për Informim e Kuvendit e lëshon një njoftim për media brenda 24 orëve.

Regjia, ziles!

Fjalën e ka deputetja Kadaj.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: E nderuara kryesuese,
Të nderuar kolegë deputetë,

Në takimin e fundit të Kryesisë së Kuvendit është refuzuar që në mënyrë të rregullt të futet pikë e rendit të ditës - Shqyrtimi i peticionit të 35 mijë qytetarëve kundër rritjes së çmimit të energjisë elektrike në Republikën e Kosovës. Është thënë që kjo pikë do të jetë në rendin e ditës në rast se komisioni arrin të takohet, të mbledhet dhe t'i shqyrtojë paraprakisht rekomandimet e dorëzuara nga komisioni.

Kjo, të nderuar kolegë deputetë, ka ndodhur dje, ndërkaq sot, siç po e shihni, në rendin e ditës nuk është kërkesa e 35 mijë qytetarëve kundër rritjes së çmimit të energjisë elektrike në Republikën e Kosovës.

Arsyeja pse nuk është, po dihet edhe nga deklarata e ish-kryeministrit Hashim Thaçi i cili tha që rryma në Kosovë është e lirë dhe unë besoj që më 18 prill qytetarët e Kosovës do të bëhen bashkë dhe do ta njoftojnë ish-kryeministrin që për 60% të atyre që jetojnë në varfëri ekstreme rryma nuk është e lirë. Nuk është e lirë as për biznese, nuk është e lirë as për të gjitha ata që e shfrytëzojnë energjinë elektrike në vend dhe Kosova nuk mund të krahasohet me Evropë për faktin e thjeshtë se atje zhvillimi ekonomik, për dallim nga ai i Kosovës, dallon shumë.

Ndoshta mirëqenia e ish-kryeministrit milioner, i cili këta miliona i fitoi në pushtet, e bën atë që të mos e ndiejë shtrenjtimin e energjisë elektrike, por besoj që për qytetarët e zakonshëm, për të gjithë ata njerëz të rëndomtë, të cilët jetojnë pa vjedhur në vendin tonë, shtrenjtimi i rrymës paraqet problem dhe ky problem është shtjelluar dhe Kuvendit të Kosovës i është dorëzuar një peticion kohë më parë.

Prandaj, në emër të grupeve parlamentare të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe “Nismës” e shtrojmë këtë propozim: Në bazë të nenit 42, paragrafi 2 i Rregullores së Kuvendit të Kosovës, kërkojmë që të bëhet amendamenti i rendit të ditës të seancës së sotme plenare me pikën, si në vijim:

- Shqyrtimi i peticionit të 35 mijë qytetarëve kundër rritjes së çmimit të energjisë elektrike në Republikën e Kosovës

a) Kërkesa e parashtruar në peticionin e 35 mijë qytetarëve ka të bëjë me të drejtat bazike e sociale të konsumatorëve të energjisë elektrike në Kosovë, gjendja e të cilëve është dëmtuar seriozisht për shkak të rritjes së vazhdueshme të çmimit të energjisë elektrike.

Për më tepër, procesi i vendimmarrjes së ZRRE-së nuk ka marrë fare parasysh kërkesat e qytetarëve, kërkesat e organizatave, të shoqërisë civile dhe shoqatat e konsumatorëve dhe i ka munguar në mënyrë të qartë transparenca e kërkuar.

Marrja e një vendimi të tillë nga ZRRE-ja prandaj është vlerësuar si tërësisht në kundërshtim me respektimin e të drejtave kushtetuese të qytetarëve të Kosovës, të cilat duhej të ishin konsideruar në kuptim të ndikimit ekonomik ndaj shportës së konsumatorit në Kosovë, sidomos kategorisë së qytetarëve, të ardhurat e të cilëve shkojnë në minimumin bazik të shportës së konsumatorit.

Kërkesat specifike të peticionit drejtuar Kuvendit i respektohen specifikisht një kërkesë që Kuvendi i Kosovës si bartës i mandatit popullor duhet t'i bëjë thirrje ZRRE-së për shkak të

dështimit të kësaj të fundit për ta udhëhequr procesin e rishikimit të çmimit të energjisë elektrike në mënyrë transparente dhe duke e konsideruar, analizuar dhe arsyetuar ndikimin e një vendimi të tillë ndaj statusit ekonomik të qytetarëve të Kosovës.

Në këtë kuptim, ne kërkojmë që sot në rend dite të jetë pika peticioni i 35 mijë qytetarëve kundër rritjes së çmimit të energjisë elektrike në Republikën e Kosovës, sepse, të nderuar kolegë deputetë, dhe i nderuar kryetar i Grupit Parlamentar, kur të flas unë, ju mund të dëgjoni dhe të prisni derisa ta përfundoj kërkesën, që është mocion procedural, i bazuar në Rregullore. Dhe, e dimë që edhe për ju çmimi i rrymës nuk është i shtrenjtë, sepse njëjtë si shefi i juaj mund ta përballoni, por për 35 mijë qytetarët e Republikës së Kosovës, të cilët kanë kërkuar që ky peticion të shqyrtohet nga Kuvendi, është i shtrenjtë.

Dhe, i ftoj kolegët deputetë që t'i përkrahin tri partitë opozitare në kërkesën tonë që të jetë pikë e rendit të ditës sot. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Rekomandimet e këtij peticioni kanë ardhur në seancën e kaluar dhe përsëri janë kthyer për rishqyrtim në komision. Kërkoj deklarin e kryetares së komisionit, zonja Lirije.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, zonja kryesuese!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Do të ishte mirë që vëmendshëm ta përcjellim arsyetimin e komisionit dhe të mos zgjatemi më tutje në këtë drejtim.

Arsyeja pse komisioni ka kërkuar të hiqet nga rendi i ditës javën e kaluar ka qenë pikërisht nevoja që të shqyrtohet raporti i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë Elektrike, ngase do të ndihmonte shumë për t'ua dhënë një pasqyrë deputetëve që arsyeshëm të gjykojnë për këtë çështje.

Meqenëse është parë e panevojshme që të shqyrtohet dhe raporti tanimë ka ardhur do të ishte e nevojshme që ai të kalohet pikërisht për këtë arsye, e jo për arsyen që u tha këtu - që të harmonizohen rekomandimet. Rekomandimet janë po të njëjtat, nuk janë prekur, me pajtueshmërinë e komisionit. Kështu që arsyeja qëndron ende, e meqë qëndron ne e presim këtë renditje, siç e kemi propozuar, dhe ecim tutje. Do të thotë, mbetet për javën tjetër, nuk ka ndonjë urgjencë.

KRYESUESJA: Meqë është mocion procedural, atëherë kërkoj deklarin e shefave të grupeve parlamentare. Zoti Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryesuese!

Vërtet është mirë që ne ta respektojmë vetveten, t'i respektojmë institucionet tona, t'i respektojmë ligjet tona, të cilat ne i kemi nxjerrë. Dhe, kërkoj që mos të lejohet të keqpërdoret foltorja e Parlamentit dhe të veprohet në kundërshtim me të gjitha rregullat që i kemi përcaktuar ne vetë dhe këto për t'i keqpërdorur thjesht për demagogji, për t'i shfrytëzuar fatkeqësitë e njerëzve, për të nxitur urrejtje brenda vetvetes.

Ju lutem, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës edhe në seancën e fundit, pra të 2 prillit, ka qenë shumë i qartë, e ka përkrahur kërkesën e Komisionit Parlamentar, i cili me Rregullore është kompetent që ta shqyrtojë raportin, ta lehtësojë punën e deputetëve, e asnjë prej deputetëve nuk ka qenë kundër shqyrtimit të këtij peticioni të nënshkrimit të 35 mijë qytetarëve.

Prandaj, kjo është një gënjeshtër. Është një tendencë për të manipuluar me vullnetin e qytetarëve, me gjendjen e vështirë sociale të qytetarëve. Përkundrazi, edhe në mbledhjen e kryesisë të mbajtur para dy ditësh, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka pasur qëndrim shumë të qartë. Kemi bërë përpjekje dhe i kemi bërë thirrje edhe opozitës. Nuk kemi dashur ta shfrytëzojmë fuqinë tonë politike, se në fund të fundit - qytetari i Kosovës është ai që e përcakton, na e ka dhënë përgjegjësinë se kush çfarë force ka.

Megjithatë, ne nuk kemi dashur ta shfrytëzojmë atë mundësi që na e ka dhënë qytetari, atë besim të qytetarit, Por, kemi dashur që vërtet këto çështje t'i harmonizojmë bashkërisht ndërmjet të gjitha grupeve parlamentare, pa përjashtim pozitë - opozitë dhe vërtet t'i japim kahun e duhur këtij problemi.

Grupi Parlamentar i Aleancës dhe opozita ka insistuar me këmbëngulje që ta imponojë një gjë të tillë, që fatkeqësisht vjen edhe sot këtu. Unë nuk flas përmendsh, por u referohem dokumenteve dhe deklaratave që i kemi. E kemi këtu një transkript, që nuk është propozuar për këtë seancë, por për një seancë tjetër.

Në anën tjetër, arsyeja ka qenë shqyrtimi i raportit dhe me Rregullore është e përcaktuar shumë qartë, që duhet të kalojë, së pari të shqyrtohet raporti në komisionet përkatëse, pastaj të vijë dhe të radhitet si pikë e rendit të ditës në Parlament. Prandaj, ne nuk kemi kërkuar, nuk kërkojmë as më shumë, as më pak, vetëm respektimin e vendimeve dhe të rregullave tona ligjore.

KRYESUESJA: Zoti Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit!

Grupi ynë parlamentar mbështet qëndrimin e kryetares së komisionit dhe të komisionit, që së bashku me raportin kjo pikë të shqyrtohet në seancën e radhës dhe askush të mos pretendojë që dikush prej nesh është për atë që u tha këtu - shtrenjtim të rrymës. Ata 35 mijë qytetarë janë qytetarë të Kosovës dhe nuk janë të partive politike, ose janë të të gjitha partive politike dhe nuk duhet të manipulohet me këtë.

Ne jemi që kjo pikë të shqyrtohet ashtu siç e meriton, me seriozitet, dhe të bëhet javën tjetër. Komisioni ta kryejë obligimin e vet, ta shqyrtojë raportin, të vijnë rekomandimet, të vijë eventualisht ndonjë rekomandim edhe për raportin dhe pastaj të gjitha këto bashkë të jenë pjesë e debatit këtu dhe të marrim qëndrim, ashtu siç është në interes të qytetarëve, e jo të një subjekti politik.

Çdo gjë tjetër që thuhet është tentim që t'u hidhet pluhur syve qytetarëve dhe është thjesht demagogji. Ne jemi që kjo pikë të jetë në seancën e radhës dhe komisioni ta kryejë punën e vet, gjë që besojmë se do ta bëjë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Zoti Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Faleminderit, kryesuese!

Zoti Grabovci tha që këtu po manipulohet rendi i ditës, në ndërkohë që këtë po e thotë vetëm sepse nënkryetarja, që po e udhëheq në këtë moment seancën, është prej Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Në ndërkohë, nuk është duke e kuptuar që ky mocion procedural është dorëzuar para fillimit të kësaj seance dhe ky mocion procedural i është dorëzuar Kadri Veselit, që është kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, i cili e ka pranuar këtë mocion procedural. Nuk është problemi te Aida, zoti Grabovci! Këtë mocion e ka pranuar Kadri Veseli. E ka marrë dhe është zotuar që ta hedhë e ta diskutojë në rend të ditës.

Mendoj që mosprania e tij në këtë moment është e qëllimshme, që të mos qëllojë në këtë moment, që të mos qëllojë në udhëheqje të seancës në këtë moment, kur ngrihet mocioni procedural. Kjo është çështje tjetër. Kjo ju takon juve. Këtë zgjidheni ju vetë!

E dyta, manipulimi me rekomandimet. Është e papranueshme që në seancën e kaluar është bërë një falsifikim i rekomandimeve, të cilat i janë paraqitur këtij Kuvendi. Duke filluar prej Gjykatës Kushtetuese, e deri në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ne po na ndodh fenomeni i papranueshëm i falsifikimit të dokumenteve zyrtare.

Në komision është folur tjetër gjë, është folur për rekomandimet origjinale të 35 mijë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Ato janë origjinale dhe si të tilla duhet të vendosen për votim dhe për shqyrtim, për debat parlamentar në këtë seancë. Neve na kanë ardhur rekomandime të përpunuara, qysh mendojnë disa përfaqësues të komisioneve aty, të subjekteve politike dhe na kanë ardhur rekomandime të ndryshuara për nga forma dhe përmbajtja e tyre. Kjo është e papranueshme.

Rekomandimet duhet të jenë ato qysh janë të formuluar prej komisionit të qytetarëve që e kanë organizuar peticionin.

E treta, këto rekomandime tash edhe së fundi u shqyrtuan në komisionin përkatës. Dhe, çfarë është me rëndësi për ne? Kërkesa jonë është e thjeshtë.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: E ftoj përfaqësuesen e “Nismës”, Teuta Haxhiu, në emër të Aleancës, por meqë Donika e prezantoi...

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetare!

Po e kuptoj se janë duke u munduar të të bëjnë presion, por për hir të transparencës në Kuvend dhe kur lexohet transkripti, edhe kryetarit të Grupit Parlamentar të PDK-së po i them, lexoje transkriptin në përgjithësi, e jo çka të konvenon.

Qysh në seancën e kaluar e kemi përmendur edhe një herë - kjo pikë të jetë pikë e rendit të ditës në këtë seancë. Këtë e kemi kërkuar. Dhe, sa i përket marrëveshjes si komision, si komision nuk e kemi kërkuar për shkak të raportit të ZRRE-së. E dimë që raporti i ZRRE-së diskutohet si pikë e veçantë dhe asnjëherë nuk duhet përzier.

Neve si komision na ka ardhur peticioni prej mbi 35 mijë qytetarë, andaj janë gati tre muaj. Deri kur duhet të mendojmë që ta vënë si pikë të rendit të ditës? Edhe dje, në takimin e komisionit që ka zgjatur deri në orën 17:00, kemi kërkuar si opozitë, pra që në emër të komisionit, për hir të transparencës, për hir të të drejtave të njeriut, të të gjithë atyre nënshkruesve, që sikur t'u ishte dhënë mundësia, do ta nënshkruanin edhe trefish më shumë qytetarë, të mos them 90% e qytetarëve të Kosovës, sepse po u bëhet shkelje e të të drejtave të njeriut vazhdimisht dhe normalisht që ka kaluar me shumicë të pozitës.

Ne kemi kërkuar që në emër të komisionit të jemi shumë transparentë, që komisioni ta kërkojë që kjo pikë sot të jetë pikë e rendit të ditës. Kështu do të ishte parimore. Pra, të mos kontrabandojmë ashtu siç na konvenon ne, por merreni transkriptet, shikojini në tërësi.

Pra, është mirë, është morale, që ne si deputetë sot të gjithë të votojmë që kjo pikë e rendit të ditës të diskutohet këtu. Kanë kaluar tre muaj. Edhe sa duhet të kalojnë, që ne të vetëdijesohemi se nuk janë politike këto, por thjesht janë shqetësime të mijëra qytetarëve. Edhe në emër të Aleancës, natyrisht, kërkoj mirëkuptimin e të gjithë deputetëve, atë që e ndiejnë edhe ta votojnë.

KRYESUESJA: Në emër të “Nismës”, Zafir Berisha e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesuese!

Natyrisht që e mbështetim mocionin që kjo çështje të trajtohet në këtë seancë, dhe unë po befasohem pse ngritët aq shumë zhurmë kur është një kërkesë në përputhje me Rregulloren, e nuk është hera e parë që po bëhet diçka e veçantë.

Unë mendoj se qëndrimi i dy grupeve më të mëdha parlamentare përkon edhe me fjalimin e vartësit të zotit Mustafa për Politikë të Jashtme, i cili tha se energjia elektrike është më e lira dhe privatisht të gjithë kolegët deputetë e kanë këtë qëndrim ndryshe, ndërsa shefat e tyre japin qëndrim krejt ndryshe.

Unë besoj se kjo çështje e iniciuar nga qytetarët më shumë se para 3 muajve duhet të trajtohet në këtë seancë edhe thjesht të kihet parasysh që ne mos t'i përmendim qytetarët vetëm atëherë kur na duhen për zhargonin publik, por hera e parë qytetarët me kërkesën e tyre tentojnë, në bazë të procedurave, të bëhen pjesë e organit vendimmarrës dhe kësaj radhe po anashkalohen. Me një fjalë, në fund, unë kisha kërkuar nga kolegët deputetë që ta trajtojmë këtë çështje në këtë seancë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Në emër të Grupit “6+”, Kujtim Paqaku

KUJTIM PAQAKU: Faleminderit, kryesuese!

35 000 nënshkrime është një shifër jashtëzakonisht shumë e madhe, që e tregon një problem serioz dhe që kërkon zgjidhje. Ky problem i ka prekur më tepër edhe komunitetet pakicë,

sidomos komunitetin rom. Kanë respekt të gjithë ata të cilët e kanë nënshkruar petitionin, prandaj kjo kërkon një shtjellim më të gjerë. Andaj, Grupi Parlamentar “6+” propozon që kjo temë të shtjellohet në seancën e ardhshme.

KRYESUESJA: Atëherë nuk ka të tjerë. Shkojmë në votim. Lus regjim që të përgatitet për votim për ta futur në rend dite këtë pikë. Votojmë tash!

Nuk kalon, 24 vota për, 37 kundër dhe 3 abstenime. Atëherë shkojmë në pauzë deri në orën...

Kemi kërkesën e deputetit Nait Hasani. Lus regjinë t’ia japë fjalën Nait Hasanit.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryesuese!

Me gjithë gabimin e vogël që e bëre, e trazove sallën, por Komisioni për Arsim ka mbajtur mbledhje dhe e ka shqyrtuar Projektligjin për Maturën dhe duke e parë rëndësinë e këtij ligji dhe afatin kohor që i duhet Kuvendit të Kosovës për ta miratuar atë, kërkon që sot në rend dite të futet Projektligji për Maturën dhe duhet të jenë 2/3 e deputetëve që të votojnë për shmangie nga rendi i ditës për shkak se kemi nevojë që ky ligj të kalojë, që nxënësit ta dinë formën e organizimit të Maturës, sepse, nëse vonohet, atëherë do ta kemi një pengesë për nxënësit tanë. Unë kërkoj që deputetët me 2/3 ta votojnë këtë projektligj në seancën e sotme.

KRYESUESJA: Të nderuar deputetë, meqë tani nuk kemi kuorum, shkojmë në pauzë deri në orën 15:00.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes pas pauzës
Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Kisha kërkuar një konsultim me shefat e grupeve parlamentare, pak para se të filloj, vetëm dy minuta.

(Ndërprerje e incizimit)

Të nderuar deputetë,
I kemi 63 deputetë të pranishëm ë sallë. Për shqyrtimin e parë të Projektligjit për provimin e Maturës shtetërore duhet të bëhet shmangie nga Rregullorja e Kuvendit, neni 15, paragrafi 7 dhe neni 56, paragrafi 1.

Mund të kërkohet deklarimi i grupeve parlamentare. Kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës. Urdhëroni, zoti Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!
Grupi Parlamentar i PDK-së e përkrah këtë ndryshim, ligjin.

KRYETARI: Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Salih.

SALIH MORINA: Faleminderit!
Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e përkrah, që ky ligj të futet në rend dite, meqë ne në Komision e kemi diskutuar dhe i gjithë Komisioni është i pajtimit dhe mendimit, që ky ligj të futet si pikë e rendit të ditës, nëse ekziston mundësia dhe Rregullorja e parasheh.

KRYETARI: Faleminderit për qartësim, se pati një reagim të deputetes.

Nevojitet 2/3-at e deputetëve prezentë në sallë. Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes” nuk është këtu. Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës nuk është këtu. Lista Serbe nuk është këtu. Grupi Parlamentar “Nisma” nuk është këtu. Grupi parlamentar “6+”.

MÜFERA ŞINIK: Tesekyrederim sagien baskan.
Altı Parti Parlamentar Gurubuda devlet sina ve yasının. Bu gyn gynleme allinmasine kabuletior.
Tesekyrederim!

KRYETARI: Faleminderit!
Atëherë, për t’iu shmangur Rregullores, Kuvendi vendos me 2/3-at e deputetëve të pranishëm në mbledhjen plenare. Shmangia mund të bëhet kur nuk bie në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me standardet evropiane, neni 84 i Rregullores së Kuvendit.

Në vazhdim kërkohet deklarimi për shmangie nga neni 15, paragrafi 7 dhe neni 56, paragrafi 1 i Rregullores, në përputhje me nenin 84 të Rregullores së Kuvendit, lidhur me afatet kohore për shpërndarjen e raportit të Komisionit FunkSIONal dhe për shqyrtimin e parë të projektligjit.

Lus regjinë dhe deputetët, që të përgatiten për votimin e shmangies nga Rregullorja. Votojmë tash!

Atëherë, konstatoj se në votim morën pjesë 62 deputetë, për votuan 61 deputetë, kemi 1 abstenim, nuk kemi votë kundër. Miratohet shmangia nga neni 15, paragrafi 7 dhe neni 56, paragrafi 1 i Rregullores lidhur me afatet kohore për shpërndarjen e raportit të Komisionit FunkSIONal dhe për shqyrtimin e parë të Projektligjit për provimin e Maturës shtetërore.

Shqyrtimi i parë i Projektligjit për provimin e Maturës shtetërore radhitet si pikë e fundit e rendit të ditës. Kërkohet nga administrata e Kuvendit, që t'ua shpërndajë deputetëve raportin e Komisionit FunkSIONal, lidhur me Projektligjin për provimin e Maturës shtetërore.

Urdhëro, zoti Grabovci!

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Unë propozoj që pika e 5-të e rendit të ditës të hiqet nga kjo seancë, të mbetet për një seancë të radhës dhe pika 9-të e rendit të ditës të futet në pikën e 5-të të rendit të ditës. Faleminderit!

KRYETARI: Lus grupet tjera parlamentare, që janë prezente këtu, për deklaram. Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës.

ISMET BEQIRI: Ne e përkrahim një mocion të tillë, gjegjësisht një kërkesë për shtyrje të kësaj pike dhe zhvendosjen e pikës së 9-të, që është aktualisht në pikën e 5-të.

KRYETARI: Grupi Parlamentar “6+”. Një deklaram formal, të lutem! Po!

Atëherë, kemi aprovimin. Realisht, pika e 5-të e rendit të ditës të shtyhet, përkatësisht që të largohet nga rendi i ditës dhe pika e 9-të e rendit të ditës, të cilën e keni pasur, futet në pikën e 5-të të rendit të ditës.

Zotërinj, kemi një ngritje formale të dorës për këtë ndryshim. Ju lutem, deputetë. Shumica janë për. A ka dikush kundër? Nuk ka kundër.

Realisht, miratohet edhe formalisht ky ndryshim i rendit të ditës. Zoti Hasani, po urdhëroni!

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Kemi një kërkesë bashkë edhe prej Komisionit edhe me deputetin Salihu, si nënkryetar i Komisionit, që pikën e 8-të të rendit të ditës për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit për Trashëgimi Kulturore, neve në Kuvend na ka ardhur ligji i ri dhe kërkojmë, që të procedojmë me ligjin e ri, derisa kemi mundësi për afatin kohor.

Prandaj, kërkojmë që të hiqet kjo dhe të shtyhet, që me ligjin e ri ta procedojmë edhe zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit për Trashëgimi Kulturore.

Kështu që, edhe ministri është dakorduar me neve dhe prandaj kërkojmë, që ta heqim.

KRYETARI: Atëherë, kërkohet një deklaram i grupeve parlamentare. Dëgjo, vetëm pak të koncentrohemi. Ju e vendosni prapë në fund. Nga Komisioni Funkcional e kemi një propozim në bashkëpunim edhe me propozuesin, me ministrinë përkatëse. Mirë është të kemi deklaram të grupeve parlamentare, pastaj e votojmë... në fund të fundit kemi votim dhe ju e votoni, e vendosni.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës.

ADEM GRABOVCI: Grupi Parlamentar i PDK-së e përkrah kërkesën e komisionit.

KRYETARI: E ka fjalën zoti Morina, nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës.

SALIH MORINA: Faleminderit!

Siç e tha edhe kryetari i komisionit, ne në Komision kemi parë që ka pak vakum ligjor, për shkak se nuk e përcakton saktë, se kush e zgjedh Këshillin për Trashëgimi Kulturore. Tash ka arritur ligji i ri në Parlament, është votuar në Qeveri dhe presim që shumë shpejt ne të japim sinjalin e gjelbër për lexim të parë. Dhe, kemi kërkuar që këta anëtarë të cilët janë propozuar deri më tani, t'i rizgjedhim nëpërmjet ligjit të ri, që do të vijë shumë shpejt, sepse do të jetë pak më në rregull, që të riemërohen anëtarët tjerë.

Prandaj, ne si grup parlamentar jemi që të shtyhet dhe të hiqet si pikë e rendit të ditës dhe të mbahet në një seancë tjetër.

KRYETARI: Grupi Parlamentar “6+”.

MÜFERA ŞINIK: Kryetar!

Ne jemi kundër. Ne jemi kundër, sepse ne kemi punuar në komision, jemi kundër.

KRYETARI: Atëherë, kemi deklarimet e grupeve parlamentare. Gjithsesi, të kemi një votim, a jemi për largimin e pikës së tetë nga rendi i ditës sot? Kush është për, le të ngrejë dorën, ju lutem.

Realisht, kemi shumicën.

Zoti Zemaj, në qoftë se dëshironi fjalën, urdhëroni, megjithëse e patëm një votim, shumica votuan për ta larguar. Dëgjo, në qoftë se doni ta komplikoni, ne edhe njëherë futemi në votim. Urdhëro zoti Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Kërkesë më joligjore, më të paarsyetuar, ky Kuvend moti s'ka pasur, e para.

Nuk mund të thirret dikush në një vendim që ka ardhur i Komisionit, që ka ardhur para Kuvendit, të thirret se do të vijë një ligj tjetër, i cili në mënyrë retroaktive do ta kthejë një çështje, e cila është në procedim. Gjejeni një arsyetim tjetër.

Qeveria ka të drejtë ta tërheq çdoherë vendimin apo ligjin e vet, por jo komisioni në këtë formë. Ju lutem!

Dhe e dyta, së pari përcakto sa deputetë marrin pjesë në votim, kjo është çështja.

KRYETARI: Atëherë, për t'i ikur komplikimit, kisha lutur regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim në mënyrë elektronike. Kush është për heqjen e pikës së 8-të nga rendi i ditës sot? Shtyrja, largimi i tërësishëm, realisht Komisioni ka dhënë propozim të largohet tërësisht nga agjenda e Parlamentit, për arsye se kemi aprovimin e ligjit të ri. Kush është për, e kisha lutur që të votojë për propozimin e Komisionit FunkSIONAL. Kush është kundër voton kundër ose abstenim.

Lus regjinë të përgatitet për votim. Votojmë tash!

Kështu, kemi një situatë kur pika e tetë mbetet në rendin e ditës, për arsye se nuk kemi kuorum. Kanë votuar vetëm 54 deputetë, 46 kanë qenë për ta larguar, 6 janë abstenime, 2 janë kundër. Faktikisht, mbetet.

Urdhëro, zoti Beqiri.

ISMET BEQIRI: Ne kërkojmë që pika 6 të shtyhet, meqenëse ministri i Financave nuk është këtu dhe ka kërkuar që të jetë i pranishëm. Të shtyhet, do të thotë pika e 6-të. Kjo është pikë që po kërkoj të shtyhet.

KRYETARI: Atëherë, e kemi një propozim nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, në koordinim me Qeverinë, me ministrinë përkatëse, që pika e 6-të të shtyhet për mbledhjen e radhës. Urdhëroni Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës.

ADEM GRABOVCI: Grupi parlamentar i PDK-së e përkrah kërkesën e Grupit Parlamentar të LDK-së.

KRYETARI: “6+”-i, urdhëroni!

MÜFERA ŞINIK: Edhe “6+”-i e përkrah propozimin e LDK-së.

KRYETARI: Një votim formal me ngritje dore, kush është për largimin?

Realisht, të mos e komplikojmë. Kjo pikë e rendit të ditës shtyhet për seancën e ardhshme plenare.

(Ndërprerje e incizimit)

Atëherë, e vazhdojmë seancën. Jemi në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Të nderuar deputetë, pyes nëse keni vërejtje në procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 26, përkatësisht 27 mars e 2 prill 2015, më 27 mars, po ashtu vazhdim seance dhe më 2 vazhdim seance, 3 e 7 prill 2015? Nëse dikush ka vërejtje, urdhëroni!

Nëse nuk ka vërejtje, atëherë konstatojmë se Kuvendi miratoi procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 26 e 27 mars e 2 prill, më 27 mars dhe me 2, përkatësisht 3 e 7 prill 2015.

Pika e katërt e rendit të ditës, faktikisht duhet ta shtyjme këtë pikë të rendit të ditës, për arsye se nuk kemi kuorum. S'ka kuorum, edhe pse ministrin e kemi këtu për ta arsyetuar. Pika e katërt e rendit të ditës shtyhet për seancën e radhës.

Atëherë, jemi në pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Propozimi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës dhe Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës për caktimin e deputetit Blerim Shala në delegacionin e Qeverisë së Kosovës për bisedime me Serbinë

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës dhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, në pajtim me pikën 4 të Rezolutës për normalizimin e marrëdhënieve në mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, miratuar në seancën plenare të mbajtur më 18 tetor 2012, kanë propozuar që deputeti Blerim Shala të caktohet koordinator i delegacionit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për bisedime me Serbinë.

E kisha lutur përfaqësuesin, apo drejt në votim? A ka ndokush nga grupet parlamentare ose nga deputetët për diskutim, le të lajmërohet me ngritje dore, ju lutem!

Pra, kush është për të marrë fjalën? Askush, a?

Nait, a dëshiron të diskutosh? A je për, apo do të diskutosh? Urdhëro, zoti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Është interesant se këtu po bëjmë një shkelje, sepse Blerim Shala zgjidhet nga Kuvendi, pikërisht për një çështje që nuk i takon Kuvendit, i takon Qeverisë, ekzekutivit.

E dyta, nëse duhet t'ia japim një rrogë, ai e ka një rrogë, e ka prej Kuvendit.

E treta. Mua më pëlqeu, kryeministri që një ditë e tha - njerëzit që kanë bërë “dashuri” me partitë tjera nuk kanë vend. Prandaj, cila është arsyeja ta votojmë ne? Faleminderit!

KRYETARI: Ju lutem, nuk ka tjerë të lajmëruar për diskutim. Kërkohe deklarimi me votim për caktimin e deputetit Blerim Shala, koordinator në delegacionin e Qeverisë së Kosovës, për bisedime me Serbinë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Kush është për?

Vetëm pak! Do ta kemi edhe një rund të ri të votimit sa për hir të publikut, për arsye se deputet ende janë jashtë. Prandaj, lus regjinë t'i thërrasim e të kthehen. Pra edhe një herë do të votojmë për arsye se më parë s'patëm kuorum.

Por, për nja 30 sekondë deri t'u bëjmë thirrje deputetëve për të ardhur, ju lus për durim!

Pra, u bëni thirrje deputetëve, për arsye se deri të regjistrohemi ju, e deri sa po flisni ju, unë vetëm po flas kot.

Realisht, në pyetjen tuaj, deputeti është deputet ynë, dihet ku e merr pagën dhe nuk është çështja e pagës, kurse ne po votojmë për një çështje shumë serioze.

E kisha lutur regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatoj se në votim morën pjesë 61 deputetë, 56 kanë votuar për, 4 kanë abstenuar dhe 1 kundër.

Konstatoj se Kuvendi e miratoi propozimin që deputeti Burim Shala, të caktohet koordinator në Delegacionin e Qeverisë së Kosovës për bisedimet me Serbinë.

Kalojmë në pikën e gjashtë:

6. Zgjedhja e kryesuesit të Komisionit Shqyrtues të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, në bazë të procedurave të parapara ligjore ka bërë përzgjedhjen e kryesuesit të Komisionit shqyrtues të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Ftoj kryetarin e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim hapësinor zoti Fikrim Damka, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqet dhe arsyetojë raportin me rekomandime. Urdhëroni zoti deputet!

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, në bazë të nenit 8 të Ligjit numër 03/L-086 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2004/49 për veprimtaritë ofruese të shërbimeve të ujësjellësit, kanalizimit dhe mbeturinave, zhvilloi procedurat për përzgjedhjen e kryesuesit të Komisionit shqyrtues të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim, dhe pas intervistës së kandidatëve, më 19 mars 2015 dhe shqyrtimit të materialit në tërësi të kandidatëve bashkë me vlerësimet e secilit anëtar të Komisionit, në të cilën morën pjesë në intervistimin e kandidatëve dhe në mbledhjen e mbajtur më 1 prill 2015 vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këtë rekomandime:

I rekomandohet Kuvendit për votim kandidaten Sabrie Abazi, për kryesuese të Komisionit shqyrtues të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim për mandat trevjeçar.

KRYESUESI: Kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare ose deputetët në qoftë se donë të diskutojnë. Është lajmëruar për fjalë zonja Brovina.

FLORA BROVINA: Faleminderit!

Së pari më lejoni që në emër të Partisë Demokratike - Grupit Parlamentar, të përkrah kandidaturën nga Komisioni dhe së dyti, personalisht flas për profesionalitetin e Sabrie Abazit.

Sabrije Abazi është një nënë vetushqyese, grua e dëshmorit, e cila iu përvesh punës që mos të fitojë poste e emërimë nëpërmjet përkrahjes së kësaj biografie, por të mësojë dhe nga dita e parë ajo kreu studimet me sukses dhe po vazhdon shkallën e tretë të studimeve.

Vetëm ky fakt le të jetë një fakt që i inspiron gratë kudo që janë se mësimi dhe studimet janë ato që hapin dyert e jo njohësitë dhe lidhjet tjera. Faleminderit, dhe kërkoj votën tuaj, sidomos të grave parlamentare dhe të gjithë tjerëve.

KRYETARI: Të nderuar deputetë, në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për zgjedhjen e zonjës Sabrie Abazi, kryesuese të Komisionit shqyrtues të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Faleminderit! Kemi 63 votues deputetë, të cilët kanë marrë pjesë në votim dhe të gjithë 63 kanë qenë për. Faleminderit!

Pra, konstatoj se Kuvendi zgjodhi zonjën Sabrije Abazi, kryesuese e Komisionit shqyrtues të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim, me mandat trevjeçar.

Kalojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Emërimi i shtatë anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, e ka shqyrtuar listën e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor, të propozuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Kuvendit i ka rekomanduar emërimin e 7 kandidatëve të propozuar për anëtarë të këtij Këshilli.

E ftoj kryetarin e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, zotin Nait Hasani, që të paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime. Urdhëroni zoti deputet!

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Ne kërkuam më herët që këtë vendim ta shtyjmë ose heqim prej rendit, sepse vjen ligji i ri dhe meqë vjen ligji i ri kemi kërkuar dhe po kërkojmë përsëri që ky proces të përmbyllet dhe t'ia lëmë ligjit të ri që ta bëjë zgjidhjen.

Prandaj, ne e kemi bërë një formë të votimit, e kemi zgjedhur ose përzgjedhur një formë, por unë besoj se nuk ka qenë formë e mirë, sepse ka pasur shumë e shumë parregullsi, hapësira në mes ligjit, prandaj kërkoj që kjo pikë të hiqet dhe të procedojmë me ligjin e ri.

Pra, ne e provuam në votim dhe kërkoj edhe një herë që ky mos të aprovohet, por të shkojmë me ligjin e ri. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëroni, kush e do fjalën? E ka fjalën Zoti Pajaziti, nga Partia Demokratike e Kosovës.

ZENUN PAJAZITI: Unë nuk po e marr fjalën në emër të Grupit, por meqenëse pati kërkesë të shtyhet, që është një kërkesë legjitime nga kryetari i Komisionit, pati edhe të tillë që e adresuan këtë çështje pak më herët.

Mendoj se, para që të dilet në sfida të tilla, Kuvendi ose Qeveria, Ministria përkatëse mos ta sjellë në të njëjtën kohë edhe projektligjin edhe një vendim të tillë. Ka pasur një procedurë të caktuar derisa kanë ardhur te ajo listë, e ndërkohë është edhe ligji. Është shumë mirë që tash ta kemi ligjin dhe unë pajtohem me shtyrjen që të mos kemi të dublifikuara dhe të pa paragjykuar si do të jetë ligji, por këto janë sfida dhe megjithatë Qeveria apo Ministria përkatëse e Kulturës të ketë kujdes për të mos sjellë për procedim në të njëjtën kohë dy çështje të tilla që janë të lidhura aq shumë njëra me tjetrën. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk kemi tjerë të paraqitur për fjalë as nga grupet parlamentare apo nga deputetët.

Atëherë, të nderuar deputetë, në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore, si në vijim:

- Shafi Gashi, shqiptar,
- Florim Isufi, shqiptar,
- Arijete Miftari, shqiptare,
- Doruntina Matoshi, shqiptare,
- Visar Haxhibeqiri, shqiptar,
- Bego Kululeri, turk,
- Filko Jovanoviq, serb,

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Dhe, paraprakisht ju lajmëroj se jemi vetëm 58 deputetë në sallë. Pra, s'kemi kuorum.

Atëherë konstatoj se Kuvendi nuk ka kuorum për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore me mandat trevjeçar.

Vazhdojmë me pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për provimin e Maturës shtetërore

Komisioni funksional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime, në parim.

Ftoj ministrin e Arsimit, zotin Arsim Bajrami, që para deputetëve të Kuvendit të prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: I nderuar kryetar i Kuvendit,
Të nderuar deputetë,
Fillimisht falënderoj për futjen e kësaj pike në rend dite. Më lejoni të bëj prezantimin e projektligjit në leximin e parë.

Projektligji për provimin e Maturës shtetërore është një rishikim i ligjit të provimit përfundimtar dhe provimet e Maturës shtetërore, i cili ishte miratuar më 6 nëntor 2008 në Kuvendin e Kosovës.

Në këtë projektligj të provimit të Maturës janë propozuar këto ndryshime.

1. Meqenëse provimi përfundimtar në shkollat profesionale rregullohet me Ligjin për arsimin dhe aftësimin profesional, kemi propozuar që provimi përfundimtar të shkollat profesionale nuk duhet të figurojë më në Ligjin për provimin e Maturës shtetërore.

2. Sipas vlerësimeve dhe analizave që i kemi bërë dhe mbi bazën e kërkesave të shkollave të mesme e të larta, të drejtorive komunale të arsimit, në mënyrë unanime si dhe të kërkesave nga prindërit dhe nxënësit, dhe duke u mbështetur në propozimet e Komisionit qendror shtetëror të Maturës, kemi propozuar heqjen e pragut të kalueshmërisë që ishte 50% dhe vendosjen e parimit të arritshmërisë që nënkupton që kandidati kalon provimin me aq pikë sa ka fituar në provim, të shprehura në përqindje të arritura në provimin e Maturës shtetërore.

3. Sipas ligjit në fuqi, nxënësi që përfundonte shkollimin e mesëm kushtëzohej me marrjen e diplomës së përfundimit të shkollës së mesme të lartë me kushtin e dhënies së pragut të kalueshmërisë në provimin e Maturës.

Në Projektligjin e propozuar, me heqjen e pragut të kalueshmërisë 50% dhe vendosjen e parimit të arritshmërisë, u mundësojmë që secili nxënës i shkollës së mesme të lartë, që paraprakisht i ka kaluar me sukses të gjitha provimet gjatë shkollimit të mesëm të lartë, t'i nënshtrohet provimit të Maturës shtetërore dhe nxënësit të marrin diplomën e shkollës së mesme me suksesin gjatë shkollimit dhe me suksesin e provimit të Maturës shtetërore. Pra, nxënësi kalon me atë sukses që e tregon në provimin e Maturës.

4. Kemi vendosur që nuk është e drejtë të kushtëzohen me marrjen e diplomës së shkollës së mesme të lartë nxënësit me kalimin e pragut të kalueshmërisë, sepse kjo ndikon negativisht, veçanërisht tek nxënësit të cilët përfundojnë shkollimin dhe shkollat e mesme profesionale, të cilët përbëjnë shumicën e shkollimit të mesëm në Kosovë.

Duke pasur parasysh se nxënësit që përfundojnë shkollat e mesme profesionale, nuk mund të punësohen pa marrjen e diplomës së shkollës së shkollës së mesme.

5. Testi i Maturës shtetërore, sipas këtij projektligji, është propozuar të mos jetë test i kalueshmërisë, por i arritshmërisë, që është ndryshe test klasifikues - rangues për qëllimet e vazhdimit të studimeve universitare dhe punësimin, e jo një test siç ka qenë deri më tani.

6. Konsiderojmë që testi i Maturës nuk mund dhe nuk guxon t'i ndëshkojë nxënësit për fajin eventual të mësimdhënësve apo për fajin e mangësive në sistemin e arsimit.

Për këtë ne do të angazhohemi të forcojmë mekanizmat e vlerësimit të nxënësve, por jo 'post festum' që nxënësit të ndëshkohen për 3 vjet, pasi kanë përfunduar shkollën e mesme të lartë.

7. Ne do të angazhohemi që mekanizmat e vlerësimit t'i forcojmë duke i vlerësuar mësimdhënësit dhe punën e tyre në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe Teknologjisë, të drejtorive komunale të arsimit, si dhe nga Agjencia Shtetërore për Vlerësimin Standardeve që do të themelohet së shpejti.

8. Duhet theksuar se heqja e pragut të kalueshmërisë nuk e relativizon fare rëndësinë e testit të Maturës, përkundrazi, sepse me këtë po sigurohet vetëm marrja e diplomës së shkollës së mesme dhe diplomës së dhënies së provimit të Maturës sipas pikëve të arritura nga secili nxënës, ndërsa universitetet dhe institucionet e arsimit të lartë e kanë mundësinë që të vendosin vetë pragje në provimin pranues për njësi të ndryshme akademike sipas kritereve të tyre akademike.

9. Provimit të Maturës mund t'i nënshtrohen të gjithë nxënësit, kandidatët e gjimnazeve të cilët me sukses pozitiv kanë përfunduar shkollën e mesme të lartë, si dhe të gjithë nxënësit kandidatë që kanë kryer me sukses provimin përfundimtar të arsimit profesional dhe të cilët dëshirojnë të vazhdojnë shkollimin në institucionin e arsimit të lartë.

10. Provimi i Maturës do të organizohet në dy afate të rregullta: afatin e qershorit, për nxënësit që diplomojnë në këtë sezon, dhe afatin e gushtit për nxënësit që mbesin në riprovim në klasën e fundit të shkollës së mesme.

Tani më lejoni që të arsyetoj me disa fjali shtesë këtë reformë të ligjit të Maturës shtetërore sepse është e nevojshme për shkak se ka pasur opinione të ndryshme në opinion.

Të nderuar deputetë, dëshiroj t'ju bindi se me asgjë nuk do të dëmtohet cilësia. Ne kemi ndërtuar në sistemin arsimor një sistem ku cilësia e mësimdhënies së paku 4 herë monitorohet nga mekanizmat e vlerësimit të jashtëm.

E dini se ne nuk kemi mundësi fare të ndërhyjmë në politikat e notimit në shkollat e mesme dhe në Universitet dhe këto janë çështje plotësisht autonome të shkollës dhe të universiteteve. Dhe qysh në klasën e gjashtë, ne kemi një vlerësim të parë të jashtëm. Vlerësimi i dytë është në klasën e nëntë dhe vlerësimi i tretë është në klasën e dymbëdhjetë kur pas diplomimit nxënësit hyjnë në provimin shtetëror të Maturës. Çfarë ka ndodhur? Ka ndodhur se kemi konstatuar që në nivel të Republikës së Kosovës në shkolla të mesme nuk kemi pasur standarde unike të vlerësimit

të studentëve. Ka pasur politika të ndryshme në komunat e ndryshme dhe ka ndodhur që gjithmonë janë ndëshkuar nxënësit për faktin se arsimtarët nuk kanë pasur standarde të vlerësimit dhe në provim të Maturës ata janë ndëshkuar. Janë ndëshkuar dhe në bazë të ligjit ekzistues këta fare nuk konsiderohen nxënës të diplomuar të shkollës së mesme, deri sa nuk e japin provimin shtetëror të Maturës.

Kjo reformë nuk e ulë aspak standardin e cilësisë, për shkak se secili nxënës do të konkurrojë në fakultet me aq pikë sa merr në provimin e Maturës. Dhe, në vend që të jetë një provim i cili në një mënyrë i diskualifikon nxënësit, ne e kemi bërë një provim i cili i rangon sipas pikëve reale që i marrin në provimin e Maturës dhe këta ne kemi paraparë që do të kenë 30% për suksesin e arritur në shkollën e mesme. Provimi i Maturës do të ketë një vlerë prej 40 pikëve dhe institucionet e arsimit të lartë e kanë mundësinë që të kenë kritere të veta për pranim. Në këtë drejtim ato janë autonome dhe kanë të drejtë për të caktuar kritere.

Mos të harrojmë se do të kemi edhe një nivel të vlerësimit, në momentin kur pas 2 muajve ta kemi Ligjin për profesionet e rregulluara. Ju e keni pa se ne kemi ndërtuar edhe nivelin e katërt të mbrojtjes së standardeve të cilësisë, që ka të bëjë që secili student i diplomuar pas diplomimit duhet ta japë tani edhe provimin e profesionit. Dëshirojmë që në treg të punës të plasojmë ekspertë, jo një elitë akademike, por ekspertë të mirëfilltë dhe pas 2 muajve këtu në Parlament do të hapet debati për Ligjin për profesionet e rregulluara sipas direktivave të Bashkimit Evropian dhe do të shihni se kemi krijuar katër nivele të monitorimit të standardeve të cilësisë, nga niveli para universitar deri te niveli universitar.

Dëshiroj edhe një herë t'ju bindi se me asgjë nuk do të lejojmë uljen e standardit të cilësisë, por do të krijojmë një sistem të garave të barabarta ku do të monitorojmë cilësinë.

Ne jemi takuar disa herë me Komisionin për Arsim, kemi vendosur një partneritet të shkëlqyeshëm dhe dëshiroj të falënderoj për urgjencën që ka treguar me këtë rast dhe ditëve e javëve të ardhshme ne do të punojmë në mënyrë intensive, si Qeveri dhe si Komision duke i pasur parasysh edhe detyrat që i kemi, duke pasur parasysh rolin e ekzekutivit dhe rolin e legjislativit. Do të jemi në dispozicion të plotë për të ofruar komente shtesë e sqarime në mënyrë që ky ligj të miratohet sa më parë dhe të mundësohet të implementohet qysh në afatin e qershorit sepse me 6 qershor është afati i parë i provimit shtetëror të Maturës dhe duhet të kemi pak kohë të mjaftueshme për të përgatitur testet e Maturës, për përgatitjen logjistike dhe trajnimin e Maturës dhe unë jam jashtëzakonisht i kënaqur që Komisioni për Arsim e ka marrë me urgjencë dhe kemi të ndërtuar njëfarë bashkëpunimi, njëfarë marrëveshje që menjëherë që nga java e ardhshme të fillojnë diskutimet e amendamentimit me rastin e leximit të dytë, në mënyrë që sa më parë të vijmë me amendamente dhe ligjit ë miratohet se padyshim është një reformë shumë e rëndësishme dhe do të mundësojë vërtet një vendosje të një rendi dhe heqjen e anomalive që i ka pasur ndoshta ligji i vjetër i cili, siç dihet, ka lënë ndoshta 3-4 gjenerata pa e kryer shkollën e mesme dhe pa mundësi të qasjes në Universitet.

Edhe një herë, ju falënderoj për bashkëpunim dhe ju lus që ta votoni këtë ligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Pas prezantimit të projektligjit, e hap debatin për diskutim në parim. E ka fjalën kryetari i Komisionit Funkcional për Arsim, zoti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje ministër,

Komisioni e ka mbajtur mbledhjen me 8.4.2015 dhe i rekomandon Kuvendit që në parim ta miratojë Ligjin për Maturën shtetërore.

Provimi i Maturës, edhe pse është kërkuar me mjaft urgjencë, është që me reformat që Ministria i ka kërkuar, janë pjesë e reformave që duhet ta zëmë afatin e qershorit dhe me këtë kemi kërkuar dhe jemi dakorduar në komision që ta bëjmë me një procedurë më të përshpejtuar. Në Komision janë parë edhe shumë vërejtje brenda ligjit dhe ne kemi kërkuar që bashkë me ministrin t'i bëjmë amendamentimet e këtyre pikave dhe amendamente që duhet të bëhen në këtë ligj dhe besoj që mund të arrijmë të kemi afatin e qershorit si pjesë e ligjit të Maturës, prandaj kërkoj nga deputetët ta votojmë në parim.

KRYETARI: Faleminderit! Kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Zoti Shpejtim Bulliqi nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Atëherë, zoti Sali Morina e ka fjalën.

SALI MORINA: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e mbështet në parim këtë projektligj dhe kërkon nga deputetët e Parlamentit që ta votojnë në parim. Faleminderit !

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Myfera Serbica-Shinik!

MYFERA SHINIK: Faleminderit, kryetar!

Devlet Sınarı Yasa Tasarısının birinci okunuşunu “6+” Parlemlenter Gurubu olarak kabul etmektedir. Yasada değışikliklerin yapılması gereğı görölmektedir. Bundandır Komisyonadaki çalışmalarımızda önerilerimizi vererek, öğrencilerimizin diploma sahibi olmalarına yasal olarak katkıda bulunacağız. Teşekkür ederim.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar,

I nderuar ministër i Arsimit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Zoti Hasani ishte në emër të Komisionit dhe ne si Grup Parlamentar e përkrahim qëndrimin e zotit Hasani dhe në veçanti iniciativën e ministrit për të ndryshuar dhe plotësuar Ligjin e Maturës.

E kemi parë edhe për këto vite se ky ligj ka nevojë të plotësohet e ndryshohet. Nevoja ishte e tillë për shkak të angazhimeve apo paraqitjes së këtij ligji në teren, është parë e nevojshme që të plotësohet e ndryshohet për arsye se një numër i madh i të rinjve e ka bërë që pas përfundimit të shkollës së mesme të mos arrijnë apo t'i plotësojnë kriteret, të jenë të stopuar nga edukimi i vazhdueshëm dhe kjo ka bërë që ndoshta edhe disa prej këtyre të rinjve pastaj të marrin rrugë tjera drejt Perëndimit.

Kemi trajtuar me Komisionin, bashkërisht dhe me të gjitha partitë në Komision, edhe ato opozitare dhe më vjen keq që sot në këtë seancë kur debatojmë për një ligj i cili është i rëndësishëm së veçanti për edukimin e brezave tanë, opozita nuk është e pranishme, të japë opsione, të japë alternativa të saj dhe mendoj se në Komisionin parlamentar po edhe më tutje, pastaj edhe në debatet publike dhe dëgjimet publike që do të jenë do të kyçet edhe opozita dhe të japë kontributin e saj për arsye se ky ligj është për të gjithë fëmijët e Kosovës e jo vetëm për ata të pozitës.

Ajo çka kemi parë deri më tani në këtë projektligj është më se e evidente se është e nevojshme që të vazhdohet edhe me hapa më tutje. Ministria e ka bërë projektligjin, mirëpo është më se e nevojshme që ky projektligj të plotësohet edhe me disa amendamente tjera, në veçanti pas dëgjimeve dhe propozimeve tuaja të nderuar kolegë deputetë.

Inkurajoj Ministrinë që të vazhdojë me digjitalizimin e provimit të Maturës dhe ky do të jetë pastaj një hap drejt të eliminimit të dy provimeve brenda një afati të shkurtër kohor. Fëmijët tanë 18 vjeçar duhet t'i nënshtrohen dy provimeve të mëdha brenda një muaji apo 30 ditëve apo më pak se 30 ditë. Është provimi shtetëror i Maturës dhe provimi në regjistrim në Universitet dhe nëse arrijmë që ne të digjitalizojmë provimin e Maturës dhe vlerësimi nga ky provim i Maturës të jetë real, atëherë ne duhet t'i stimulojmë nxënësit më të mirë që të kenë mundësinë të zgjedhin profesionet të cilët ata i dëshirojnë, nxënësit më të mirë të cilët do të dalin në provimin e Maturës dhe të arrijnë të kenë dëshirë aty ku dëshirojnë ata të studiojnë dhe pastaj për ata të tjerët të ketë hapësirë që të regjistrohen në universitetet tjera.

Deri më tani, propozimi që është në nenin 17, nga ana e Ministrisë ka qenë që shkollimi i mesëm të vlerësohet me 30%, provimi shtetëror i Maturës të vlerësohet me 40% dhe regjistrimi apo provimi në Universitet të jetë me 30%.

Mendoj se këtu kemi nevojë ta plotësojmë, derisa s'e bëjmë digjitalizimin e provimit shtetëror të Maturës për arsye se një provim i Maturës vlerësohet më tepër se shkollimi në tërësi i shkollës së mesme. Dhe kjo për momentin nuk është reale për arsye se ndodh që një nxënës i cili mund të jetë i zhdërvjelltë në një moment të provimit pranues apo të ndihmohet nga dikush nga jashtë, ta kalojë një nxënës i cili ka qenë i shkëlqyeshëm gjatë tërë viteve shkollore. Mendoj se duhet të korrigjohen këto mundësi të poentimeve dhe e përqindjeve dhe në momentin që të arrijmë digjitalizimin atëherë ajo të bëhet në mënyrë automatike në bazë të vlerësimeve nga provimi shtetëror i Maturës kur do ta kemi vlerësimin real.

Unë falënderoj ministrin dhe kërkoj edhe nga ju deputetë të gjithë që keni mundësi, po flasim për një provim shtetëror të Maturës, i cili prek të gjithë dhe në veçanti fëmijët tanë, që të japin kontributin e tyre dhe pastaj edhe ne si Komision të procedojmë me të gjitha sferat e interesit, në dëgjimet publike dhe pastaj në fund të jetë vërtet një konsensus i përgjithshëm kur ta miratojmë këtë ligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E ka fjalën zoti Bulliqi.

SHPEJTIM BULLIQI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!
I respektuar ministër,

Të respektuar kolegë deputetë,

Sigurisht se vlen t'i shprehim një falënderim ministrit të Arsimit, i cili ka qenë racional në hartimin e këtij projektligji. Mendojmë se projektligji i kaluar i Maturës ka pasur nevojë ndoshta edhe më herët të freskohet e të plotësohet, prandaj mendoj që me këtë projektligj ne do të kemi mundësi ta nxjerrim një projektligj i cili do të jetë shumë i përshtatshëm dhe do të jetë në favor të gjithë nxënësve të cilët e mbarojnë shkollën e mesme të lartë.

Sigurisht se projektligji do të kalojë prapë nëpër duart tona dhe besoj që ne do i japim sugjerimet e vërejtjet tona, do ta plotësojmë aty ku na e merr mendja se mund të ketë ndonjë mangësi, mirëpo paraprakisht do të kërkoja nga ministri i Arsimit, përkatësisht nga Këshilli shtetëror i Maturës që mundësisht të kihet parasysh fakti, sepse në projektligjin e mëhershëm që ka ekzistuar, disa drejtime në provimin final të Maturës, kanë qenë disa lëndë që realisht i janë shtruar si pyetje përkundër faktit që ndoshta dy vitet e fundit ka mund që fare mos ta dëgjojnë atë lëndë, disa prej nxënësve në drejtime të caktuara. Domethënë, duhet të kihet parasysh që kjo problematikë të evitohet.

E dyta e mirë e këtij ligji, mendoj është që po hiqet pragu për arsye se ne jemi dëshmitarë të faktit që një numër i madh i nxënësve nuk kanë arritur të kalojnë prapun e 50% prandaj ndoshta janë zhagitur me vite të tëra derisa kanë arritur të kalojnë atë prag, kështu që mendoj se do të ketë mundësi që me kriteret tjera në pranimin nëpër njësitë akademike, domethënë, në njëfarë forme të zgjidhen ata që janë më të mirët.

Dhe çështja tjetër që ia vlen besoj të diskutohet dhe të analizohet e shqyrtohet edhe një herë, janë kriteret rreth mënyrës së përzgjedhjes së nxënësve në njësitë akademike dhe poentomi dhe pikat - poenët që do të merren nga provimi i Maturës, nga suksesi i përgjithshëm në shkollën e mesme të lartë e kështu me radhë. Dhe të gjitha këto, do të thotë, në njëfarë forme të ndryshohen dhe të bëhen në atë formë që në njëfarë forme në këtë fazë derisa të bëhet digjitalizimi i testit të Maturës, në njëfarë forme t'i jepet një përparësi çështjeve të njësive akademike që ato realisht ta bëjnë një selektim më të mirë të tyre.

Sigurisht që krejt këto besoj gjatë kësaj faze do të shqyrtohen, plotësohen dhe besoj se do ta nxjerrim një projektligj i cili do të jetë i përshtatshëm për të gjithë.
Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka deputetë tjerë të paraqitur për diskutim. I nderuar ministër, e dëshironi edhe një herë fjalën?

Atëherë, jemi para një situate kur ne vetë kërkuam që të futet në rend dite, kurse në këtë moment kur po flasim nuk kemi kuorum për të vazhduar më tutje. Realisht ne jemi të varur me projektligjet nga Qeveria, por sido që të jetë i jemi nënshtruar si deputetë një vëzhgimi kritik nga shumica, sepse i kemi vetëm 7-8 ligje që i kemi kaluar, e po e bëjmë një vit mandat si deputetë të këtij Kuvendi, dhe duhet të jemi edhe vetëkritikë. Mirupafshim në seancën e radhës!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*